

REPORTAZH



**BULQIZA NË NJË FILM TË YLLI PEPOS**

Në dy orë të filmit dokumentar "...E nderit është nëntoka e Bulqizës..." eidentohen resurset e shumta mbi e nëntokësore dhe historia e lavdishme e kësaj treve

HALIL RAMA – Mjeshtër i Madh

Faqe 6-7

FAMILJA KOÇI, NJË NDËR ATO QË I KA DHËNË SHUMË MINIERËS



**FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT, GJENERUESE E PRODHIMIT**

Faqe 8-9

*E pranishme në konstituimin e këshillit Bashkiak Bulqizë, Zv/Kryeministrja Belinda Balluku*

# BETOHET KRYETARJA E RE E BASHKISË FESTIME MJESHTRI, KONSTITUOHET KËSHILLI

**BULQIZA, NJË UNIVERSITET I DYTË PËR TË GJITHË KUADROT QË PUNUAN NË MINIERË E GJEOLGJI**  
**PROF. DR. GAFUR MUKA**  
 Për ta sinkronizuar sa më mirë filmin "...E nderit është nëntoka e Bulqizës...", regjisori Pepo dhe konsulentit Cukalla, jo pa qëllim kanë zgjedhur opinionin e Prof. dr.Gafur Mukës.  
 Vijon në faqen 7



• Për mandatin 4-vjeçar të saponisur, kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Festime Mjeshtri, do të fokusohet kryesisht në përmirësimin infrastrukturor, bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik. Në intervistën ekskluzive për "Gazeta Bulqiza" ajo pohon se ka nisur punën për bërjen realitet të premtimeve të fushatës elektorale, që sipas saj, kanë qënë rezultat i një analize që ka kryer më parë bashkë me ekipin, bazuar në nevojat e komunitetit

Faqe 2,3

**AKTUALITET** Faqe 4  
**Martin Cukalla: Shfrytëzimi i kromit, duhet menaxhim më i drejtë nga shteti**

**AKTUALITET** Faqe 12  
**Me "Rrugën e Arbrit", Bulqiza si "lagje e Tiranës"**

**TURIZMI** Faqe 13  
  
**Peladhia – fshati magjik rrëzë Tëmlës, katund i arsimtarëve dhe trashëgimisë historike**

**DR. ADRIATIK BALLA**

**Shoqata Atdhetare Kulturore Bulqiza në aktivitete të larmishme**  
**RESPEKT E MIRËNJOHJE PËR RRËNJËT TONA**  
 Kryetari i Komunës Podujevë z.Shpejtim Bulliqi, vlerësoj përpara pjesmarrësve, figurën e ekonomistit llapjan Xhemshit Duriqi dhe pershëndeti grupin e vizitorëve bulqizakë që morën pjesë në këtë përkujtim. Ai tha se është me rëndësi të kemi bashkëpunim e shkëmbim përvojë, Komuna Podujevë me Bashkinë Bulqizë, duke realizuar marrëveshje binjakëzimi në një kohë të përshtatëshme  
 NGA BASHKIM LAMI - Kryetar i Shoqatës "BULQIZA"  
 Faqe 10

**HISTORIA** Faqe 11  
**Beteja e Dibrës, 3-11 prill 1941**  
 NGA SAKIP CAMI

**SUPLEMENTI LETRAT** Faqe 14  
**Rrëfime rreth kritikës përmes, reportazhit letrar**  
  
 NGA EMI KROSI

**SUPLEMENTI LETRAT** Faqe 15  
**Ka ca amanete...**  
  
 Cikël poetik nga Barie Çupi

# Betohet kryetarja e re e bashkisë Festime Mjeshtri, konstituohet këshilli

• 27 Qershor, 2023 - Është betuar si kryetare e re e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri e cila do të drejtojë bashkinë për katër vitet e ardhshme, si dhe është konstituuar këshilli bashkiak i bashkisë Bulqizë i cili do të përfaqësohet me 21 këshilltarë.

Është betuar si kryetare e re e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri e cila do të drejtojë bashkinë për katër vitet e ardhshme, si dhe është konstituuar këshilli bashkiak i bashkisë Bulqizë i cili do të përfaqësohet me 21 këshilltarë.

Në krye të këshillit bashkiak pas disa debatëve për t'ju përmbajtur rregullores u zgjodh Arben Çupi përfaqësues i Partisë Socialiste, i cili arriti të merrte 12 vota nga 21 anëtarë të këshillit në total, ku shumica e vendeve në këshillin bashkiak e ka Partia Socialiste me 9 anëtarë, ndjekur nga koalicioni "Bashkë Fitojmë" me tre anëtarë dhe 9 subjektet e tjerë do të përfaqësohen me nga një anëtarë.

Festime Mjeshtri arriti të siguronte fitoren në zgjedhjet e 14 majit me 60.20% të votave, e cila do të jetë kandidatja e parë femër në krye të bashkisë Bulqizë. Pas betimit Kryebashkiakja e cili do të përfaqësojë bashkinë për vite u shpreh se në mandatin e saj do të jetë transparente për të gjitha premtimet e saj gjatë fushatës dhe se stafi i bashkisë Bulqize do të jetë në shërbim të gjithë banorëve të Bulqizës.

Pas betimit, kryetares se re ju vendos shiriti i kryetarit, duke u vendosur në krye të kesaj Bashkie per kater vjecarin qe vjen, e cila eshte e para kryetare femer qe do te drejtojë bashkine.

Me këtë rast ajo përshëndeti banorët e Bulqizës dhe tha se do të jetë transparente për të gjitha premtimet e saj gjatë fushatës dhe se stafi i bashkisë Bulqize do të jetë në shërbim të gjithë banorëve



**FESTIME MJESHTRI**

të Bulqizes.

Pas betimit kryetarja e re e bashkisë Bulqize Festime Mjeshtri ju drejtua zyrës duke nisur ditën e pare të punës.

E pranishme në konstituimin e këshillit Bashkiak ishte Zv Kryeministrja Belinda Balluku e cila ishte e deleguar për qarkun Dibër gjatë zgjedhjeve të 14 majit.

**Konstituohet Këshilli i ri i Qarkut Dibër.  
Zgjidhen kryetarja dhe nënkryetari**

## Alma Selami do drejtojë Këshillin e Qarkut Dibër

**5 Korrik, 2023** - Është zhvilluar mbledhja e parë e Këshillit të ri të Qarkut Dibër, mbledhje në të cilën është bërë dhe konstituimi i këtij këshilli.

17 këshilltarët që përbëjnë këtë këshill zgjodhën mes tyre dhe drejtuesin e ri për këtë mandat katër vjeçar.

Për kryetar të Këshillit të Qarkut Dibër u propozua emri i anëtares së këtij këshilli, Alma Selami. Pas votimit të fshehtë me 17 vota pro dhe asnjë kundër në krye të këshillit për 4 vitet e ardhshme do të jetë Alma Selami. Pas zgjedhjes në krye të këshillit, Alma Selami vijoi me drejtimin e mbledhjes ku u diskutuan pikat e tjera të rendit të ditës. Anëtarët e këshillit zgjodhën dhe nënkryetarin, Armand Gjinin, ku me të gjitha votat ai mori mandatin 4 vjeçar. Mbeshtetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" nenet 73; 74; 75 dhe 77 në raportin e Komisionit të Mandateve, në procesverbalin e Komisionit të Votimit, Këshilli i Qarkut Diber, në mbledhjen e datës 05.07.2023. vendosi e Kryesisë së Këshillit të Qarkut Dibër me këtë përbërje : Alma SELAMI - Kryetar; Armand GJINI - Zv / Kryetar dhe anëtarë: Rahim SPAHIU, Agron MALAJ, Valbona KOLA, Festime MJESHTRI dhe Erjon GJESTILA.

Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Qarku i Dibrës përbëhet nga katër Bashki, të cilat janë:

**Bashkia Dibër** e cila përbëhet nga qyteti i Peshkopisë dhe 14 njësi administrative.

**Bashkia Mat** e cila përbëhet nga qyteti i Burrelit dhe shtatë njësi administrative.

**Bashkia Bulqizë** e cila përbëhet nga qyteti i Bulqizës dhe shtatë njësi administrative.

**Bashkia Klos** e cila përbëhet nga qyteti i Klosit me rrethinat e tij dhe tre njësi administrative.

## Mbledhja e parë mbas konstituimit

**6 Korrik, 2023** - Në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Bulqizë, është zhvilluar mbledhja e parë e këtij këshilli pas konstituimit të tij. Mbledhjen e hapi kryetari i këshillit Bashkiak Bulqizë, Arben Çupi, i cili bëri prezent edhe pikat që do të diskutoheshin dhe miratoheshin në këtë mbledhje.

Pika e parë e rendit të ditës, kishte të bënte me miratimin në parim të listës së aplikanteve për ndihmë ekonomike, nga grandi i 6% -shit, të deleguara për shpërndarje për muajin maj të këtij viti, ku nga ky grand kanë përfituar 220 familje. Pas diskutimeve kjo listë u kalua në votim nga ku mori edhe miratimin e këshilltarëve.

Një tjetër pikë e rëndësishme ishte edhe

miratimi i pagave për nënpunësit civil dhe administratën e Bashkisë Bulqizë, pikë të cilën e paraqiti për miratim në këshill, Drejtori i Buri-meve Njerëzore pranë Bashkisë, Korab Kika.

Pikë tjetër e rëndësishme për këtë mbledhje ishte edhe zgjedhja e sekretarit të këshillit bashkiak. Në këtë pikë u hodh për votim pro dhe kundër emri i sekretarit aktual të këtij këshilli Fitim Balla, i cili pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave u zgjodh për herë të dyte në këtë detyrë.

Sekretari i saporizgjedhur Fitim Balla, shprehu angazhimin për zbatimin e rregullores së këshillit bashkiak që ky këshill të funksjonojë më së miri.

/btvnews.al



# Në fokus infrastruktura, bujqësia dhe zhvillimi ekonomik

**KUSH ËSHTË FESTIME MJESHTRI**

**K**a punuar për shumë vite në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Bulqizë, në zyrën e promocionit dhe edukimit shëndetësor. Gjatë kësaj kohe, ajo ka bashkëpunuar me shumë organizata kombëtare dhe ndër-kombëtare për implementimin e një sërë projektsh edukuese dhe informuese në fushën e shëndetit publik në qarkun e Dibrës.

Nisur nga angazhimi i saj i madh dhe puna që ka bërë në shërbim të komunitetit, veçanërisht gjatë pandemisë së COVID-19, znj. Mjeshtri u promovua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në pozicionin e drejtoreshës së Spitalit Bashkiak Bulqizë. Pas një viti në këtë detyrë, ajo u propozua që të kandidonte për postin e kryetares së Bashkisë Bulqizë. Kandidimi i saj u përkrah masivisht nga komuniteti, çka u dëshmuar dhe nga rezultatet e zgjedhjeve vendore të majit 2023, ku znj. Mjeshtri fitoi bindshëm.

Kryetarja aktuale e Bashkisë Bulqizë ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti A. Xhuvani, Elbasan. Ajo gjithashtu ka marrë pjesë në konferenca dhe evente, duke qenë e përditësuar me politikat shëndetësore në nivel qendror dhe lokal.

Paralelisht me aktivitetin e saj profesional, znj. Mjeshtri ka qenë e angazhuar në politikë për shumë vite. Ajo e njeht mirë qarkun e Dibrës, dhe specifikisht bashkinë e Bulqizës, kulturën dhe traditat, si dhe nevojat e njerëzve të kësaj zone. Mjafton një shikim i shpejtë në rrjetet sociale, për të kuptuar se Kryetarja që nga dita e marrjes së detyrës po punon çdo ditë për të zgjidhur problemet e banorëve, duke u fokusuar fillimisht tek bujqësia, sektori që 'vuan' më shumë nga thatësitrat. Më konkretisht vizioni i saj shpaloset në intervistën e mëposhtme.

**Znj. Kryetare, ju përgëzojmë për këtë detyrë dhe përgjegjësi të re! Së pari, ne dhe gjithë lexuesit jemi të interesuar të dimë, a keni një plan zhvillimor për bashkinë e Bulqizës dhe nëse po ku konsistojnë pikat kryesore të këtij plani?**

Përhëndetje! Ju falenderoj që jeni këtu dhe keni shprehur interes për të folur për pikat e planit zhvillimor për bashkinë Bulqizë. Sigurisht që ka një plan, sigurisht që ka një vizion të cilin e kam shpalosur edhe gjatë fushatës sime elektorale. Premtimet e mia në fushatë, kanë qënë rezultat i një analize që kam kryer më parë bashkë me ekipin tim, bazuar në nevojat e komunitetit.

Puna e Bashkisë Bulqizë do të përqëndrohet në disa drejtime. Fillimisht do të planifikojmë investimet në infrastrukturë dhe kemi nisur në fakt me projektet e para, disa prej tyre kanë qënë në proces. Kam qënë vetë në terren për të parë jo vetëm ecurinë e punimeve por edhe cilësinë e tyre. Infrastruktura është domosdoshmëri dhe do të përqipemi të adresojmë këtë shqetësim të banorëve duke ndërhyrë edhe në lagje, pasi është thelbësore për lehtësimin e lëvizjes së tyre. Sigurisht që do të kushtoj vëmendje të veçantë edhe njësisë administrative të Bashkisë së Bulqizës. Do të vazhdojmë investimet në zonat rurale, për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet publike.

Përgjatë muajit korrik kemi patur prioritet fermerët e të gjitha zonave administrative. Kemi ndërhyrë me aksion për rehabilitimin e kanaleve vaditëse dhe kulluese që ujitja e tokave bujqësore të mos mungojë në asnjë sekond. Investimet në Bujqësi do të jenë prezente gjatë gjithë kohës, pasi e shikojmë si një sektor që ndikon edhe në zhvillimin e ekonomisë së zonës.

Gjatë muajit gusht do të vlerësojmë nevojat për investime në shkolla, kopshte, çerdhe dhe do të ndërhyjmë sipas prioritetëve. Do të kemi një vëmendje të veçantë tek grupet vulerarabël, kryesisht ata që trajtohen me ndihmë ekonomike nga Bashkia.

Një fokus të rëndësishëm Bashkia Bulqizë do ta

**• Për mandatin 4-vjeçar të saponisur, kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Festime Mjeshtri, do të fokusohet kryesisht në përmirësimin infrastrukturor, bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik. Në këtë intervistë ekskluzive për "Gazeta Bulqiza" ajo pohon se ka nisur punën për bërjen realitet të premtimeve të fushatës elektorale, që sipas saj, kanë qënë rezultat i një analize që ka kryer më parë bashkë me ekipin, bazuar në nevojat e komunitetit.**



ketë tek personat me aftësi ndryshe. Tani që po flasim, përmes një projekti të mbështetur financiarisht nga Fondi Social, do të bëjmë të mundur zgjerimin e shërbimeve sociale në 8 njësitë administrative të Bashkisë Bulqizë. Do të ofrojmë shërbime të specializuara në familje dhe në Qendrën Ditore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi ndryshe. Ata do të përfitojnë rregullisht shërbime mbështetëse psiko-sociale, terapeutike, etj., duke u dhënë mundësinë të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë. Gjithashtu, do të kërkojmë bashkëpunimin e donatorëve ndërkombëtarë për të tërhequr sa më shumë fonde, për të rritur gamën e shërbimeve që bashkia mund të ofrojë. Përshebull, aktualisht me mbështetjen e Qeverisë Britanike kemi një qendër sociale të lëvizishme, ku organizohen aktivitete për fëmijët dhe të rinjtë. Qendra po mundëson arsimimin dhe shërbimet psiko-sociale. Do të këmbëngulim në zgjerimin e të tilla partneriteteve që sjellin më shumë fonde dhe zhvillim për Bulqizën.

Kemi plane për mjedisin. Nuk do të ketë plehra në rrugë, nuk do të ketë ndotje mjedisi, por gjatë gjithë vitit do të realizohen aksione pastrimi duke ecur në linjë me Planin Kombëtar të Pastrimit. Do bëjmë sistemimin e kazanëve të plehrave dhe do të punojmë për ndërgjegjësimin e komunitetit, pasi mbajtja pastër e mjedisit kërkon bashkëpunimin e të gjithëve.

Do të kemi një fokus të veçantë tek të rinjtë. Do të punoj për të krijuar më shumë mundësi punësimi për të rinjtë, duke inkurajuar krijimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Ata gjithashtu do jenë pjesë e rëndësishme edhe e administratës së Bashkisë Bulqizë. Në të njëjtën kohë, do të krijoj programe për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe artistike

në qytet. Kjo do të inkurajojë të rinjtë të angazhohen në aktivitete në kohën e tyre të lirë. Për kulturën, do të ketë investime në organizimin e eventeve kulturore dhe festivale që do të promovojnë kulturën lokale dhe traditën.

Do të bashkëpunojmë me operatorët turistikë lokalë, apo shoqatat që punojnë në fushën e turizmit për të promovuar turizmin në zonën e Bulqizës. Dhe investimet në infrastrukturë ndihmojnë shumë në këtë drejtim.

Vetëm me investime konkrete mund të arrijmë që Bashkia e Bulqizës të jetë një vend i përshtatshëm për të jetuar, punuar dhe investuar, duke siguruar mundësi punësimi, duke nxitur zhvillimin e bizneseve lokale, duke rritur cilësinë e jetës së qytetarëve.

**Cilat janë problemet më emergjente që keni evidencuar?**

Sikurse e thashë më lart, plani ynë për zhvillimin e Bulqizës është hartuar bazuar në një analizë të nevojave akute, pra që kanë nevojë për ndërhyrje të menjehershme dhe atyre që do të bëhen sipas një planifikimi të mëvonshëm. Prioriteti i parë ishte bujqësia për shkak të thatësirave dhe kushteve jo të favorshme. Ishte e nevojshme ndërhyrja për të siguruar infrastrukturën e nevojshme të ujitjes, përmes pastrimit të vazhdueshëm të rrjetit të ujitjes dhe kullimit në të gjitha njësitë administrative për të rritur eficientë aktuale. Përgjatë gjithë muajit gusht, nuk do të ketë pushim, por identifikim dhe priorizim të nevojave për ndërhyrje duke filluar nga infrastruktura e institucioneve publike: shkolla, kopshte, çerdhe, ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përmirësim të shërbimeve publike, nxitje të punësimin me fokus të veçantë tek të rinjtë, mbështetje për bujqësinë etj.

**Bulqiza ka resurse të shumta mbi e nëntokësore. Cili është vizioni juaj për shfrytëzimin e tyre në dobi të komunitetit?**

Gjatë fushatës sime e kam përmendur si një pikë të veçantë planin për resurset nëntokësore. Bulqiza është vërtet një bashki me një sipërfaqe të madhe dhe me një nëntokë të pasur, veçanërisht me galeritë e kromit. E para, prioritare është siguria në punë të cilën do ta monitorojmë në bashkëpunim me institucionet përkatëse në nivel qendror. Është domosdoshmëri krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune për ata që punojnë në galeritë e kromit, ndaj dhe do të kërkojmë marrja e të gjitha masave të nevojshme për sigurinë e tyre. Gjithashtu, do të kërkojmë marrëveshje me kompanitë e minierave që punojnë në zonën tonë për të garantuar se ata respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe që kontribuojnë në rritjen e ekonomisë së Bashkisë Bulqizë në mënyrë të qëndrueshme.

Gjithashtu do të inkurajoj përdorimin e teknologjive të avancuara për të zvogëluar ndikimin e proceseve të shfrytëzimit në mjedis, si dhe për të përmirësuar kushtet e punës për punonjësit në galeri. Gjithashtu, do të punoj për të rritur kontributin e industrisë së kromit në zhvillimin ekonomik të Bashkisë Bulqizë.

Në përgjithësi, do të punojmë që Bashkia Bulqizë të ketë një plan të qartë dhe të zbatueshëm për shfrytëzimin e pasurive natyrore, duke marrë parasysh kujdesin për mjedisin dhe për mirëqenien e banorëve të kësaj zone.

**Intervistoi: Halil RAMA**

Ish-drejtori i minierës 4 dekada më parë  
apelon për krijimin e shërbimit Gjeologjik  
për Bulqizën

aktualitet

# Martin Cukalla: Shfrytëzimi i kromit, duhet menaxhim më i drejtë nga shteti

**G**aleritë e kromit në Bulqizë po shfrytëzohen nga kompanitë private pa kriter dhe pa një plan për të ardhmen e kësaj miniere. Revervat mund të shterojnë brenda 75 viteve të ardhshme nëse nuk krijohet Shërbimi Gjeologjik për Bulqizën.

Shqetësimi ngrihet nga Martin Cukalla, ish-zv.ministri i Industrisë dhe ish-drejtori i minierës së Bulqizës në vitet 1975 deri në 1981 dhe i rikthyer në vitet 1985 deri në 1987.

'Shteti si përfaqësues i popullit nuk ka atë dorë që duhet të ketë për shfrytëzimin e minierave dhe ju është lënë orekseve të njerëzve të fortë, menaxhimi. Oresket e njerëzve të fortë nuk janë gjithmonë të drejta, nuk janë gjithnjë në favor të së tërës. Kjo është një miniere që duhet të ketë unitetin e vet. Mund të ketë shumë që e shfrytëzojnë dhe e ndajnë në shumë sektorë, por duhet të jetë dhe ajo që i bashkon të gjithë këta sektorë, një menaxhim më i drejtë nga shteti që



• *Miniera e kromit në Bulqizë po shfrytëzohet pa kriter nga kompanitë private, ndërsa roli i shtetit është i dobët, tha Martin Cukalla në një intervistë për Report TV. Ish-drejtori i minierës 4 dekada më parë apelon për krijimin e shërbimit Gjeologjik për Bulqizën*

jon sa më parë shërbimin gjeologjik për Bulqizën. 'Më e keqja është se nuk ka atë që i paraprin, nuk ka shërbimin gjeologjik, që shton rezervat, kështu që krijohen probleme, krijohen konflikte dhe ndjehet ndërhyrja që duhet t'i jepte shteti situatës në të cilën ndodhet Bulqiza. Deri tani janë shfrytëzuar diku te gjysma rezervave të sasisë së mundshme, dmth unë i jap jo pak jetë Bulqizës, por edhe 70-75 vjet jetë minierës së kromit. Këtu kërkohet roli i shërbimit gjeologjik dhe duhet të jetë emergjencë krijimi i shërbimit Gjeologjik për Bulqizën. Sipas mendimit tim, tani më teknike nuk është thellësia drejtimi kryesor i rezervave që mbetet për të ardhmen, por zgjerimi, pra janë krahët e minierës.' - tha Cukalla.

Ndërsa për minatorët, Cukalla tha se punojnë në kushtet të vështira dhe në rrezik për jetën ndaj duhet të kenë pagë dhe më pas pension dinjitoz.

'Natyra ka tekcat e veta dhe është e vështirë që t'i dalësh përpara, është problem për njerëzit që hyjnë në minierë. Për këta njerëz që luftojnë me nëntokën duhet të ketë respekt maksimal dhe duhet të jepet shpërblymimi i duhur për sakrificat që ata bëjnë në këtë minierë.' -tha Cukalla.

Martin Cukalla, tashmë në pension foli për Report TV gjatë një vizite familjare në muzeun e qytetit të Bul-

qizës, ndërtuar kohët e fundit me përgjegjës Pëllumb Dervishin, i cili e njohu me fotot e dokumentet e rralla.

## Në rrugën e fshatit Fshat, barrierat metalike të shkatërruara

**B**arrierat metalike në rrugën e fshatit Fshat nga rreth-rrotullimi e deri tek ura e fshatit, janë thuar se gjitha të dëmtuara. Dhjetra drejtues automjesh ankohen se sa herë ka lagështi në rrugë, nga reshjet e shirave ndodhin aksidente të shumta për shkak se automjetet rrëshkasin. Disa drejtues mjetesh dyshojnë se mund të hidhet qëllimisht vaj makinash e të tjerë akuzojnë për cilësinë e asfaltit.

Ajo që vihet re nga të gjithë janë barrierat e dëmtuara si pasojë e përplasjes së automjeteve në to. Drejtuesit e mjeteve kërkojnë që të merren masa pasi kjo rrugë është edhe në zonë të banuar pasi kalon përmes shtëpive të fshatit Fshat dhe mund të ndodhë që të shkaktohet aksidente me pasojë të rënda në humbje jetësh njerëzore. Një problematikë e ngjashme me rrëshkitjen e automjeteve në ditët me lagështi prej vitesh ka qenë edhe në fshatin Kokërdhok të Ulzës, ku si pasojë e pranisë së ujit asfalti kthehej si akull e mjetet përfundonin jashtë rrugë. /btvnews.al

## APELI I NJË BLEGTORI PËR RININË: MERRUNI ME BAGËTI, MOS BRAKTISNI VENDIN

**V**endi ynë po njeh një rënie të frikshme të numrit të bagëtisë pasi shumë prej atyre që janë marrë me tai kanë braktisur. Në fshatra, ashtu siç gjen më pak njerëz, gjen më pak edhe blektori, qofshin të imta apo gjedhë.

E kjo e ka një shpjegim i cili lidhet drejtpërdrejt me largimin e të rinjëve. Por, megjithëse nuk ka ndonjë numër të madh bagëtish, Bib Gjinaj nga fshati Suç i Klosit, ju bën apel të rinjëve të mos e braktisin vendin, por të punojnë në vendin e tyre, qoftë edhe duke mbarështuar bagëti.

Biba na tregon se ai shkollon me bagëti të imtë çdo ditë pasi është pensionist, por thotë se prej tyre merr edhe përfitime ekonomike për shkak të rritjes së çmimit të mishit, si dhe të nënprodukteve të qumshutit. Për shkak se në fshatra jetojnë më së shumti moshë e tretë, numri i krerëve të bagëtisë ka rënë ndjeshëm, duke e bërë fshatin të duket si i shkretë. /btvnews.al

## U VIHET FLAKA DY MAKIMAVE TË PARKUARA NË KRASTË

12 Korrik, 2023 - Dy automjeteve të parkuara në Krastë të Bulqizës u është vënë zjarri. Sipas policisë, një automjet tip "Benz" është shkrumbuar plotësisht, ndërsa një "Land Rover" parkuar pranë tij është djegur pjesërisht.

Njoftimi i Policisë: "Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Bulqizë referuan materialet në Prokurori, për veprën penale "Shkatër-

rimi i pronës me zjarr", pasi në Krastë, Bulqizë, është djegur automjeti tip "Benz", në pronësi të shtetasit D. M., si dhe është djegur pjesërisht automjeti tip "Land Rover" (që ishte i parkuar pranë automjetit tip "Benz"), në pronësi të një shtetasi tjetër. Vijon puna për zbardhjen dhe dokumentimin e kësaj ngjarjeje, identifikimin dhe kapjen e autorëve", bën me dije policia.

btvnews.al

btvnews.al



për fat të keq nuk mendoj se është.' - u shpreh Cukalla.

Sipas tij rezervat e kromit mund të shterojnë nëse shteti nuk kri-

## INVESTIM ME VLERË QË DO NDIKOJË NË ZHVILLIMIN E ZONËS

**N**jë tjetër rrugë fshati po asfaltohet në Bashikinë e Bulqizës. Bëhet fjalë për rrugën e fshatit Bllacë në Njësinë Administrative Shupenzë ku ndodhet edhe vendi i shenjtë i teqesë së Bllacës.

Rruga me gjatësi afro 3.6 kilometra që nis nga rruga e asfaltuar në fshatin Kovashicë dhe përfundon pranë teqesë së Ismail Jangullit në fshatin Bllacë, po asfaltohet e gjitha.

Banorët e Bllacës thonë se përfitimet nga asfaltimi i rrugës janë të shumta që nga vizitorët që tërheq teqeja e Bllacës e deri tek transport i prodhimeve bujqësore drejt qendrave

urbane.

Banorët shpresojnë që investimi të vijojë edhe pak më larg që është parashikuar në projekt, pasi zhvillimi ekonomik do të jetë akoma më i madh.

Nga ana tjetër banorët shpresojnë që këto investime do të ndikojnë direkt për zhvillimin e zonës dhe rikthimin e atyre banorëve që janë larguar për të investuar në vendlindjen e tyre.

Vlera e investimit është rreth 34.4 milion lekë të rinj dhe punimet pritet të mbyllën brenda një afati kohor prej 1 muaj ditë kalendarike.

# Shoqata Atdhetare Kulturore Bulqiza në aktivitete të larmishme

**PREGATITI: BASHKIM LAMI**  
KRYETAR EKZEKUTIV I SHOQATËS

Kryesia e “Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza” ka vazhduar veprimtaritë e saj me aktivitete të ndryshme në zbatim të synimeve për të mbajtur lidhje me komunitetin e trevave të Bashkisë Bulqizë duke bashkëpunuar edhe me institucione e shoqata të tjera të këtyre zonave. Me datë 9 qershor 2023, u organizua në Tiranë një mbledhje e hapur e kryesisë së “Shoqatës Bulqiza” me intelektualë të shquar të fushave të ndryshme, që kanë dhënë kontribute të rëndësishme në profesionet e tyre në Bulqizë.

Nga kryesia u paraqit përpara pjesëmarrësve një informacion i detajuar mbi aktivitetet që ka zhvilluar shoqata dhe synimet në të ardhmen e afërt. Bashkëbisedimi ishte shumë konstruktiv dhe u shpalosën nga pjesëmarrësit mendime dhe ide të rëndësishme, që lidhen me zhvillimin e Bulqizës në shumë fusha si dhe evidentimi i vlerave historike, organizative e të biznesit duke njohur edhe problematikat aktuale të komunitetit. Hapi takimin presidenti i “Shoqatës Bulqiza” prof.dr.Islam Dauti, që uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, duke vlerësuar rëndësinë që ka kontributi vullnetar që na mban edhe më afër me vendlindjen tone, duke njohur gjëndjen aktuale dhe duke debatuar rreth synimit që të bëjmë diçka që na mban të afruar me njëri tjetrin dhe me Bulqizën prej nga vimë. Kryetari shoqatës Bashkim Lami paraqiti me detaje ecurinë e funksionimit të “Shoqatës Bulqiza”



## PLANI I AKTIVITETEVE TË SHOQATËS PËR VITIN 2023

Nën drejtimin e sekretarit ekzekutiv të shoqatës, Hamit Dërvishi, u paraqit plani i aktiviteteve të shoqatës për vitin 2023, ku përfshihen takime me përfqesuesit e Këshillit dhe të administratës së Bashkisë, njohja me problematikën e sindikatave lidhur me statusin e të drejtat e minatorëve, takime me përfaqësues të biznesit, që mund të bashkëpunojnë për të mbështetur disa aktivitete që janë në dobi të komunitetit për probleme të ndryshme.

U trajtua organizimi i një simpoziumi shkencor në këtë vit të 75 vjetorit të minierës dhe të qytetit Bulqizë. Do të kemi një aktivitet me krijuesit e rinj në shkollat 9-vjeçare e të mesme të Bashkisë Bulqizë; vlerësimin e njerëzve të shquar që kanë dhënë kontribute të paharruara gjatë punës e jetës së tyre në

## Shoqata Bulqiza nderon me certifikata figurat e shquara të qytetit

Lidhja me qytetin dhe nxjerrja në pah e vlerave të tij ishin tema kryesore e diskutimeve, ku pjesëmarrësit ishin të mendimit se historia e Bulqizës duhet të shkruhet dhe t’u lihet si trashëgimi brezave. Gjatë kësaj mbledhje që zgjati më shumë se 90 minuta u diskutua se si do të organizohet shoqata për të ardhmen dhe çfarë aktiviteteve duhet të organizohen që lidhja me qytetin të jetë prezente.

Pas diskutimeve konstruktive u vendos që të gjithë të bëjnë kërkime dhe të dërgojnë artikuj të ndryshëm për të promovuar qytetin dhe të jenë si një dëshmi e së shkuarës për të ardhmen.

Po ashtu u përfaqua dhe propozimi që në vitin jubile të 75-vjetorit të minierës, të organizohet një festë dinjtoze dhe kjo festë të kthehet një traditë për qytetin. Nuk munguan dhe planet për aktivitetet kulturore dhe turistike për të pasur sa më shumë takime që do shërbejnë për të forcuar lidhjet mes anëtarëve.

Në fund shoqata nderoi me certifikata mirënjohje disa prej figurave që kanë dhënë kontribute për vite me radhë për Bulqizën dhe Shqipërinë. /btvnews.al

## Zhvillohet pelengrinazhi i përvitshëm i Ballem Sulltanit, të pranishëm mijëra besimtarë

30 Qershor, 2023 - Qindra besimtarë dhe besimtare nga e gjithë Shqipëria që i përkasin fesë bektashiane kanë shkuar për të festuar në vendin e quajtur Ballem Sulltan, të njësisë administrative Martanesh të rrethit të Bulqizës, ku është bërë pelengrinazhi i përvitshëm botëror i cili festohet me 29 qershor të çdo viti. Besimtarë dhe besimtare janë ngjitur drejt vendit të shejntë i Ballem Sulltanit të cilët kanë ndezur qirinj duke shprehur lutjet e tyre. Në këtë pelegrinazh ishte i pranishëm kryegjyshi botëror DEDE Edmond Brahimaj, kryetarja e Bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri dhe shumë Baballarë të Tyrbeve nga e gjithë Shqipëria.

Në fjalën e tij kleriku i madh Dede Edmond Brahimaj tha se është pikërisht ky vend i shenjtë që na largon enegjitë negative dhe na bën të reflektojmë duke marrë uratat e njëri tjetrit.

Ndërkohë Edmond Brahimaj kërkoi që të lutemi që bota të këtë paqë dhe jo luftë siç po ndodh me Ukrainën dhe Rusinë. Edhe babai i teqesë së Balenjës Hysni Shehu përshëndeti pjesëmarrësit në këtë pelengrinazh që zhvillohet çdo vit në këtë vend të bekuar.

Kryetarja e Bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri në fjalën e saj përshëndetëse u shpreh se Bashkia me mbështetjen e qeverisë do ta kthejë Martaneshin në një antraksion turistik për të gjithë turistët vendas dhe të huaj.

Në mbyllje të këtij pelengrinazhi dhanë për mikrofonin tonë mesazhet e festës edhe Baba Mondit, baba Hysni e besimtarë të tjere.

/btvnews.al



dhe synimet për të ardhmen.

Dr. shkenc. gjeografike Adriatik Balla, zv/kryetar i Shoqatës ndoqi me vemendje pyetjet e diskutimet e pjesëmarrësve në këtë takim të hapur, që na bën të ndjehemi mirë kur shtohen rradhët e kontributeve të interesuar për arritjet dhe problemet që ka ai komunitet ku ne kemi të afërmit, shokët e miqtë tanë, që nuk mund ti harrojmë.

Prof.dr Gafurr Muka tha në fjalën e tij, se është e nevojshme dhe e domosdoshme që studentët nga trevat e Bulqizës të marrin pjesë në forma të ndryshme në aktivitetet e shoqatës, ku mund të fitojnë një eekspierencë positive për të qenë të lidhur me komunitetin prej nga vijme të gjithë.

Mjeshtri i Madh, shkrimtari e publicisti Halil Rama vuri theksin tek lidhja e bashkëpunimi me shoqatën e “Intelektualëve dibranë”, “Bashkësia dibrane”. “Kalabardha”, “Gryka e Madhe”, “Gryka e Vogël”, “Martaneshi”, etj.

Beznesmeni pronar i TV Bulqiza Edmond Isaku dhe mësuesi Mehdi Karaj ngritën zërin për organizimin e një feste masive, që do bashkonte banorët e trevave të Bulqizës në një ditë të veçantë, ku të shpalosen vlerat historike, kulturore, artistike, etnografike dhe traditat më të bukura të fshatrave të asaj zone.

Bulqizë dhe do të organizohen eskursione e festa me pjesëmarrje të komunitetit në bashkëpunim edhe me institucionet shkollore e social kulturore.

Z..Medin Karaj, drejtor i departamentit të oranzimit, shtroj disa probleme të organizimit për shtrirjen e veprimtarive të shoqatës Bulqiza në terren dhe në grupet shoqërore që na mbështesin në qytete e vende të tjera ku jetojnë anëtarë të komunitetit me prejardhje nga trevat e Bulqizës.

Në këtë takim u bë dekorimi me certifikatën “NDERI I SHOQATËS ATDHETARE KULTURORE BULQIZA” i disa intelektualëve të shquar që kanë dhënë kontributin e tyre për shumë vite në Bulqizë dhe në vende të tjera të Shqipërisë, duke u bërë shembull si qytetar model dhe profesionist të shquar, që mbajnë lart dashurinë e tyre për vendlindjen tonë, Bulqizën, si Gafurr Muka; Hamit Dërvishi; Halil Rama; Edmond Isaku; Naile Karaj; Ylvije Cani; Nafije Jella; Rudina Spahiu; Ikbali Lami; etj. U theksua se kryesia e kësaj shoqate do të evidentoj dhe nderoj edhe njerës të tjerë të shquar në fusha të ndryshme të profesioneve e detyrave shoqërore të rëndësishme në dobi të komunitetit duke mbetur të paharruar e shembull për brezat e ardhshëm.

Takimi u mbyll me një koktej modest ku pjesëmarrësit bënë biseda të lira për të evokuar histori të bukura jetësore që lidhen me jetën e tyre të përditëshme.

Në dy orë të filmit dokumentar "...E nderit është nëntoka e Bulqizës..."  
"evidentohen resurset e shumta mbi e nëntokësore dhe historia e  
lavdishme e kësaj treve

reportazh

# BULQIZA NË NJË FILM TË YLLI PEPOS

HALIL RAMA

Resurset e shumta mbi e nëntokësore të Bulqizës dhe historia e lavdishme e kësaj treve, kësaj here vijnë artistikisht për publikun nëpërmjet një filmi dokumentar. Gazetarja e njohur e Radio Tiranës, Suzana Zyrrakja, autore e qindra emisioneve radiofonike, por edhe e një dokumentarëve televizive shkroi skenarin nën kujdesin, konsulencën e ndihmën e pakursyer të poetit të mirënjohur Martin Cukalla, ish-drejtor i minierës më të madhe të kromit në vend. Edhe titulli i filmit vjen nga një varg poetik i Martinit: "...E nderit është nëntoka e Bulqizës...". Rrallë ndodh që një varg, i zgjedhur nga veprat poetike, të jetë titull filmi!

Por ai nuk mungoi as në sheshet e xhirimit, kur me regjisorin e mirënjohur Ylli Pepo, nuk kanë ngurruar që së bashku të nisin realizimin e filmit.

Dhe ja, mëngjezin e një dite të zakonshme vjeshte janë gjendur në një nga sheshet e qytetit minororë mes dhjetra veteranëve, të ardhur nga të gjitha skajet, edhe nga pertej oqeanit. Është një takim brezash.

Kësisoj, Ylli Pepo, regjisor, gazetar, skenarist që ka realizuar suksesshëm një mori telereportazhezh e filmash dokumentarë, që ka xhiruar dhjetra filma për personalitetet dhe ngjarjet historike të shqiptarëve, kësaj here është përqëndruar në një zonë të paeksploruar. Dhe jo pa qëllim e nis filmin me të rënë në galeritë e nëntokës së Bulqizës. Që në film teleshikuesve do t'ju duhet të fokusohen në një sallë, ku: "...si një mjegull e bardhë, nga errësira e galerive, vijnë edhe të rënë në apelin që hap takimin. Bujar Keta, Ismet Ymeri, Lavderim Lika, Mehmet Xhediku, Sadik Deda, Servet Islami, Lutfi Smeli, Skender Leka, Sakip Muça, Axhem Xhepa, Myftar Begu, Luan Hoxha, . Miftar Gjoka.

S'janë 5 as 10 por plot 300 emra! Në apel përgjigjet shpirti i tyre. Ata mbeten aty, në galeri, gjatë disa dekadave.

300 minatorë, punëtorë e specialistë. Në mbi 7 dekada të krijimit dhe shfrytëzimit të Minierës së Bulqizës, dhanë jetën në krye të detyrës. Edhe pse llamba e karbitit iu shua në balë ata mbeten në gjirin e tokës si në legjendën shqiptare të murimit.

Ata u futën në gjë të tokës për të nxjerrë thesaret e saj dhe mbeten aty si gurë themeli të forta për vazhdimësinë e minierës ndër vite..."

Martin Cukalla që ka përjetuar dhimbshëm castë të trishtat të rënies dhe të lamtumirës së disa prej tyre, si një nga drejtorët më të suksesshëm të kësaj miniere, kurrësesi nuk mund ta niste ndryshe skenarin e këtij filmi, veçse me homazhin dhe nderimin e këtyre heronjve të nëntokës.

Ndërsa regjisor Pepo, si për ta kaluar sa më lehtë këtë moment të trishtë, përcjell nëpërmjet filmit muzikë...pamje nga

• Prof. dr. Gafur Muka, me modesti është shprehur në këtë film se nuk teprohet aspak kur thuhet se Bulqiza ishte një universitet i dytë për të gjithë kuadrot që punuan në minierë e gjeologji. "Në këtë universitet ishin të gjitha format e mësimdhënies: leksionet - përvoja e atyre që kishin shumë vite në minierë, seminarët - specifika e të dhënave që kërkonin zgjidhje, laboratorët - gjithë ambienti mbi - e nëntokë ku zhvillohej aktiviteti për kërkimin, zbulimin, hapjen dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit dhe provimet - hartimi i projektprogrameve vjetore dhe mbrojtja e tyre para komisioneve teknike e shkencore. Kur largohesh nga Bulqiza kishe vetëdijen e një profesionisti të certifikuar dhe krenarinë e përballimit të sfidave që nuk përsëdytëshin", thotë prof.Muka, i cili, personalisht ndjehet me fat që u përfshi në "armatën" e atyre që e bënë Bulqizën"



HALIL RAMA

Bulqiza...rrugët e saj... Dhe si një nga ikonat e dokumentarit televiziv i jep filmit nuanca artistike ku përdoren mjeshhtërisht dhe fotot me pamje nga natyra e Bulqizës... Një natyrë e virgjër që do të frymëzonte poetët, shkrimtarët, skenaristët e regjisorët më të famshëm të botë.

## THUA BULQIZË, KE THËNË KROM...

Në vijim të skenarit që përmban elementë të një eseje të gjatë letrare, në këtë film jepet Bulqiza ku banorët shkelin mbi nëntokën më të pasur në Europë për kromin që bart. Brenda skenarit është poezia e Martin Cukallës: "Thua Bulqizë, ke thënë krom". Filmi evidenton kështu përmes pamjesh filmike, episdoesh e intervistash një nga trevat e Dibrës me histori të veçantë. E njohur për luftrat e saj për liri e pavarësi të Shqipërisë. E njohur për thesaret e mineralit të kromit të fshehura në barkun e maleve.

Gjithkush që do ta ndjekë këtë film do të magjepset nga dy portat hyrje e dalje: Ura e qytetit me Harqe dhe Qafa e Buallit...me Bulqizën që ka fusha të mëdha për prodhime bujqësore e blegtorale. Janë vërtetë bukuri mahnitëse ato të fushës së Gjoricës, Boçevës, Shupenzës dhe Okshtunit. "Hambari i Dibrës në brigjet e Drinit të Zi" janë cilësuar ato.

Ndërkohë konsulentit Cukalla kurrësesi nuk mund t'i "shpëtonin" dy burime hidrike të fuqishme të kësaj treve: Zalli i Okshtunit në Lindje dhe ai i Bulqizës në Perëndim. Rezerva të mëdha hidrike këto, prej kohësh të njohura e të shfrytëzuara, pamjet e të cilave shfaqen me tërë madhësinë e tyre në këtë film.

Detaje prekëse në këtë film nga natyra që i ka falur Bulqizës pasuri të mëdha natyrore. Një terren mjaft mbrojtës, rrethuar me male, gjelbëruar nga lloje drurësh si lisi, shkoza, panja,ahu. Male,

liqene, miniera, pyje, pllaja e livadhe piktoreske, me shumëllojshmëri bimësh medicinale, si sherebela, dëllenja, qershija e egër etj. Burime natyrore, stane....Filmi paraqet një peisazh madhështor e të virgjër. E të mendosh për ata që i mbijetojnë dimrit të acartë, që ulet këmbëkryq me muaj në këtë zonë, kur erërat e forta dhe bora i kalojnë kufijtë e normales.

## QYTETI I MINATORËVE NË VERILINDJE TË VENDIT, MË I VARFËRI MBI NËNTOKËN E TIJ TË PASUR

Më të besueshëm e bëjnë filmin kronikat e kohës, nxjerrë nga arkivi i RTSH-së. Paraqiten në to zhvillimet të fundviteve 1960 dhe në fillim të viteve "70-të, kur kjo minierë e ka renditur Shqipërinë në vendin e katërt në botë për sasinë e nxjerrjes së mineralit të kromit me cilësi të lartë për shkrimje. Atëhere deklarohet se miniera e kromit Bulqizë jepte 32-37 përqind të të ardhurave kombëtare në shkallë vendi. Megjithatë Bulqiza, qyteti i minatorëve në verilindje të vendit mbetej e varfër mbi nëntokën e saj të pasur!

I ilustruar me kronikat e kohës me moton "Kromi çan bllokadën", filmi sjell bindshëm në memorian e bashkëkohësve vitet 1980-1990, kur vetëm në zonën veriore janë hapur 8 puse vertikale dhe 8 dishenteri. Është koha kur në krye të kantierit që ndërtoi këto punime të mëdha ishte burri nga Fushë Bulqiza Nazmi Perkola, një drejtues i talentuar, i lidhur ngushtë me vendin e vet. Nazmiu filloi punën në minierë që në vitin e parë të jetës së saj dhe aty u rrit si specialist e kuadër. Në minierë punoi për 42 vjet rresht deri sa doli në pension në vitin 1990. Në këtë film ai prezantohet si kuadri i papërtur, i lidhur nushtë me njerëzit e ballit të galerive, në krye të sakrificave, i zoti të zgjidhte problemet e

shumta e të vështira që cfaqte nëntoka. Nazmi Përkola gjithë jetën e vet në minierë mbeti porta ku trokiste minatori dhe fukaraja.

## HARMONI UNIKALE NDËRMJET FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË FILMIT

Në atë mori planesh filmike të ndërlydhura, të shoqëruara me zë apo jo, të cilat krijojnë efektin e lëvizjes, në harmoni unike ndërmjet formës dhe përmbajtjes, padyshim shkelqen edhe montazhi i mjeshtrit të njohur Gjergji Pano, ku vend parësor zë perkushtimi i njerezve që e bënë minierën e Bulqizës të shenonte vetem rritje...Dhe jo vetëm në prodhimin e mineralit të çmuar të kromit, por edhe në krijimin e instancave ndihmëse.

Në 120 minuta ( i ndarë në dy pjesë) momente kulmore të këtij filmi, shifra dhe fakte, shoqëruar me foto e dokumenta arkivore që të mbërthejnë pas ekranit për të mësuar ecurinë e tyre ndër vite. Kështu mësojmë se më 1950 u krijua bërthama e parë gjeologjike dhe se deri në vitin 1952 në Bulqizë kishte vetëm baraka ku strehoheshin punëtorët. Por pas këtij viti u ndërtuan me radhë zyrat për ndërmarrjen e minierës së kromit, për ndërmarrjen gjeologjike, ndërmarrjen e furnizimit të punëtorëve.

Nën një regji perfekte, operatorët e këtij filmi janë fokusuar në momentë të zgjerimit të qytetit të Bulqizës që ka ecur krahas me zgjerimin e punimeve minerare. Gjithashtu filmi evokon vështirësi të mëdha, terrene të thepisura malesh, pa rrugë normale, nëpër të cilat minatorët me krahë transportin sondat, motorrat e pompat me pesha shumë të mëdha. Të thuash ndërgegjeje e pastër punëtorë, është kaq pak...i kalon tejskajshmerisht kufijtë e perkushtimit. Moment prekës, çasti kur kujtohen gjeologët e talentuar e të sakrificës së madhe: Koço Gushi, Sefedin Qorlaze, Todi Sema etj., që me punë të pakursyer e mendime përgjithësuese të mbështetura shkencërisht, i dhanë hov shtimit të pandërprerë të rezervave të këtij minerali të dobishëm dhe i hapën krahë shfrytëzimit në mënyrë të vazhdueshme e deri më sot.

Nëpërmjet sinkroneve ish drejtues të minierës së Bulqizës tregojnë se kulmi ishte kur në vitet 1984 - 87 miniera arriti të realizojë afro 500 mijë ton krom cdo vit, derisa punimet minerare në ato vite arritën rekord mbi 40000 ml. Këto arritje do të shënonin bilancin optimal me mbi 15 milion ton krom që janë nxjerrë nga nëntoka e Bulqizës në afro 7 dekada kohë...

# reportazh

• Në vijim të skenarit që përmban elementë të një eseje të gjatë letrare, në këtë film jepet Bulqiza ku banorët shkelin mbi nëntokën më të pasur në Europë për kromin që bart. Brenda skenarit është poezia e Martin Cukallës: "Thua Bulqizë, ke thënë krom". Filmi evidenton kështu përmes pamjesh filmike, episdoesh e intervistash një nga trevat e Dibrës me histori të veçantë. E njohur për luftrat e saj për liri e pavarësi të Shqipërisë. E njohur për thesaret e mineralit të kromit të fshehura në barkun e maleve...Më të larmishëm e bëjnë filmin edhe sinkronet e Ing. Bukurosh Koçit, ing. Gjergj Xekës, specialisteve gjermanë etj, në gojën e të cilëve jepet gjithë dinamika e zhvillimit të minierës së Bulqizës dhe e gjithë kësaj treve lavdiplote..



## BULQIZA KA HISTORINË E SAJ SI PJESË TË LAVDISË SHQIPTARE

Për të realizuar sa më artistikisht filmin, regjisorin dhe operatorët në një moment janë ngjitur lart, në majë të malit të Duriçit. Që këtu kra-hina e Bulqizës duket si në pëllëmbë të dorës. Poshtë këtij mali fshihet thesari i nëntokës, minerali i kromit!

Ketu spikat dukshëm kamera e mrekuullueshme e Drejtorit te talentuar te figurës Xhemal Recit.

Po. Siç e përshjkruan skenari, Bulqiza ka historinë e saj, si pjesë të lavdisë shqiptare. E kjo histori jepër madhërishëm në këtë film kur paraqitet Ura me tre harqe që është një dëshmi ilirike. Banorët e Bulqizës ruajnë në memorien kolektive epopenë Skënderbejane. Ndaj dhe rrënqetthesh nga ilustrimi me betejat në Vajkal të Bulqizes në vitin



1465, kur Heroi ynë Kombëtar, Skenderbeu përballi fitimtar dy beteja kundër pushtuesve osmanë. Pjesë vitale e filmit është dhe Memoriali "GURËT E SKËN-

DERBEUT, vepër e skulptorit të ri Edmond Balja. Memorial ky ndanë anës së Fushës së Vajkalit, i realizuar me mbështetjen e disa sipërmarrësve, bij të Bulqizes që në film pasqyrohet nëpërmjet kronikës së asaj dite të inagurimit.

Historia e minierës së kromit në Bulqizë, si një legjendë rrëfëhet nga veteranët, kronikanët të gjallë të kësaj historie të jetuar. Si në përralla thuhet se zbulimi i kromit në minierën e Bulqizës u bë rastësisht gjatë kohës së pushtimit italian.

Në fillim të vitit 1948 qeveria shqiptare vendosi të fillojë punimet për nxjerrjen e mineralit të kromit në Bulqizë. Më 18 Shkurt 1948 erdhën tetë puntorë nga Rubiku me në krye Xhavit Hatibin dhe trembëdhjetë puntorë nga zona e Bulqizës. Ajo ishte dita e parë e punës.

Imazhe frymëzuese filmike improvizuese kur në lartësinë mbi 1000 metra mbi nivelin e detit, në Ahishten e Madhe të malit të Duriçit jepet shpërthimi i parë i minave që thërmonin shkëmbin e gurit me xixa që shënonte dhe fillimin e punës për nxjerrjen e mineralit të çmuar në Bulqizë. Bashkëkohësit tregojnë se gjatë këtij viti u prodhua 10500 ton mineral kromi. Drejtori i parë i minierës ishte Jorgji Traja, kryeinxhinieri i parë i saj ishte Dhori Pano. Ndër vite prodhimi i kromit do zinte hapsira të reja e sektorë të rinj do hapeshin: Batra, Krasta; Thekna, Cerruja, Shkalla, Selishta..

Në kronikat e kohës përmenden emrat e minatoreve e specialistëve të parë, si: Osman Losha, Tosum Spahiu, Myrteza Duriçi, Gjergj Prenga, Sulejman Ruta, Hamit Duriçi, Liman Zogu, Adem Hasa, Gjin Kola e të tjere. Janë këta heronjtë e parë që do të shtronin trasenë ku do të ecnin qindra e mijëra minatorë e specialistë të tjerë nder dekada.

Në film jepen imazhe të një shtegtimi nëpër nëntokë në mbi 100000 km pune minerare. Improvizime të realizuar mjaftë mirë artistikisht në film janë ato të atyre fillimeve të largëta si "pyetje në çdo rrefim historie", kur minerali nxirrej në sipërfaqe me karroca dore. Specialistët tregojnë se vetëm pas 10 viteve, aty nga 1958-ta u arrit shfrytëzimi i minierës me galeri nënkat. E pastaj me radhë shfrytëzimi i pusit 1...2...me tri nivele. Mjaft nga këto momente, si fletë ditari të kohës, na vinë nga kronikat filmike, që dikur shfaqeshin në kinematë dhe autokinematë e shumta që çonin filmin deri në skajet më të largëta të vendit. Dhe s'ka se si në këtë film të mos kujtohen me respekt drejtorët e atyre viteve: Sinan Xhemili, Ferit Alla, Sotir Dodona etj; inxhinieret: Andrea Xega, Niko Lula, Zija Çeliku, Vilson Myftiu etj; minatorët: Kamber Duriçi, Hasan Jashari, Sali Shehu, Zef Bib Lleshi, Pjeter Recit, Kole Arapi, Kadri Suli, Veli Kola, Servet Islami, Lutfi Smeli, Fais Kaci, Islam Spahiu etj.; mekaniket: Encio Xhimitiku, Fahrudin Shehu, Edip Kaloshi, Ilija Kocaqi, Skender Keta, Shefqet Duriçi etj.

### Prof. GAFUR MUKA: BULQIZA, NJË UNIVERSITET I DYTË PËR TË GJITHË KUADROT QË PUNUAN NË MINIERË E GJEOLGJI



UET, Departamenti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, autor i 5 teksteve mësimore dhe i mbi 40 referateve, artikujve e projekteve brenda e jashtë vendit, si dhe autor i monografise "Geo-Risk Maps for Management of Abandoned Mine Workings Exploitations", Publisher: LAP LAMBERT Academic Publishing, Berlin, 2018.

Prof.Muka, me modesti është shprehur në këtë film se nuk teprohet aspak kur thuhet se Bulqiza ishte një universitet i dytë për të gjithë kuadrot që punuan në minierë e gjeologji. "Në këtë universitet ishin të gjitha format e mësimdhënies: leksionet - përvoja e atyre që kishin shumë vite në minierë, seminarët - specifika e të dhënave që kërkonin zgjidhje, laboratorët - gjithë ambienti mbi - e nëntokë ku zhvillohej aktiviteti për kërkimin, zbulimin, hapjen dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit dhe provimet - hartimi i projektprogrameve vjetore dhe mbrojtja e tyre para komisioneve teknike e shkencore. Kur largohesh nga Bulqiza kishe vetëdijen e një profesionisti të certifikuar dhe krenarinë e përballimit të sfidave që nuk përsëdytëshin", thotë prof.Muka, i cili personalisht ndjehet me fat që u përfshi në

"armatën" e atyre që e bënë Bulqizën".

Më të larmishëm e bëjnë filmin edhe sinkronet e Ing. Bukurosh Koçit, ing. Gjergj Xekës, specialisteve gjermanë etj, në gojën e të cilëve jepet gjithë dinamika e zhvillimit të minierës së Bulqizës dhe e gjithë kësaj treve lavdiplote..

Xhirimet e këtij dokumentari vijuan edhe në mjediset e shkollës së mesme profesionale Bulqizë ku u fol për ing.Osman Mihën-"Oytetar Nderi" i Bulqizës, ndër themeluesit dhe drejtuesit më jetëgjatë të kësaj shkolle që ka luajtur rol kryesor në aftësimin profesional të minatorëve e specialistëve. Përpjekjet në këtë fushë nisën që në vitin 1952-1953 kur u hap shkolla e mbrëmjes për punëtorët e Bulqizës. Kohë kur sapo ishin vendosur këtu dhe familjet e para të minatorëve. Në vitin 1970 u hap shkolla e mesme profesionale e ditës me degën për teknikë miniere e më pas u zgjerua me degët gjeologji dhe shpim puseh. Për veprimtarinë e gjatë të Osman Mihës, si në fushën e inxhinierisë, ashtu edhe në drejtimin e shkollës e mësimdhënies shembullore flasin me respekt, jo vetëm bashkohësit, por edhe më të rinjtë nga gjenerata e elitës bulqizake.

Për ta sinkronizuar sa më mirë filmin, regjisorin Pepo dhe konsulentin Cukalla, jo pa qëllim kanë zgjedhur opinionin e Prof.dr.Gafur Mukës. Kjo për faktin se ai që e ka nisur karrierën në galeritë e Bulqizës për të arritur deri në instancat më të larta si ish diplomat në Ambasadën e RSH në Bonn, Gjermani, Anëtar i Unionit European të Konsulencës (ECU). E.C.U. – European Consultants Unit, pedagog në Fakultetin Gjeologji Miniera dhe në

### PROFILE DREJTUESISH QË FRYMËZOJNË

Pa profilizimin e atyre që i dhanë jetë minierës më të madhe të kromit në vend, filmi do të ishte i mangët. Por konsulentin Cukalla dhe regjisorin Pepo janë treguar tejet të vëmendshëm në evidentimin dhe promovimin e tyre, duke na i paraqitur ata me foto e çaste të sinkronizuara në frontet e punës. Kështu, periudha me ritëm rritje veçanërisht të lartë për minierën e Bulqizës lidhet me një emër të veçantë për Bulqizën: **Bujar Pata** kryeinxhinieri dhe drejtori i palodhur e i pakursyer në përpjekjet e veta për të zgjidhur çështjet e vështira që kishte nxjerrja e kromit. Djalë i një familje modeste nga Peladhia, Bujar Pata u formua inxhinier miniere në Universitetin e Tiranës dhe iu përkushtua profesionit të vet duke e njesuar jetën e tij me atë të minierës. Miniera dhe njerëzit e saj. Në film tregohen histori njerëzore, heroike, të heshtura, të thjeshta deri në madhështi...

**Inxhinier Todo Manço** në vitin 1955 transferohet në Bulqizë si kryeinxhinier i minierës. Një ish partizan syapatrembur, i diplomuar në Poloni inxhinier miner, sakrifikoi gjithë jetën në këtë minierë. Në këtë film ai evidentohet si miku i minatorëve dhe i gjithë qytetarëve, balli i luftës kundër vështirësive të motit e rreziqeve të nëntokës, që me personalitetin dhe veprimtarinë e çmuar, u bë emblema dhe frymëzim për të gjithë inxhinierët e minierave të vendit.

(Vijon në faqen 8)



Në dy orë të filmit dokumentar “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...” evidentohen resurset e shumta mbi e nëntokësore dhe historinë e lavdishme e kësaj treve

# reportazh



• **Ing. Bukurosh Koçi**, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për “njolla në biografi” sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërrnovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkëpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë; po ashtu autor dhe bashkautor i ndërtimit të disa Fabrikave e impianteve për pasurimin e mineralit të kromeve të varfëra, si dhe i disa rikonstruksione Fabrikash Pasurimi, ka ngritur e konsoliduar një Shoqëri nga e cila janë përpunuar dhe vazhdojnë të ripërpunohen mbi 2.5 milion ton sterile dambe, duke prodhuar koncentrat kromi për eksport

## FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT, GJENERUESE E PRODHIMIT

Intervista me Bukurosh Koçin lidhur me ringjalljen e Fabrikës së Pasurimit të kromit, investimet e kryera, teknologjitë e avancuara që aplikohen, si dhe materialin që vetë fabrika prodhon zë vend të veçantë në filmin “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...” të Ylli Pepos, Martin Cukallës e Suzana Zyrakës. Bukuroshi argumenton se nëse sasia e përgjithshme e mineralit të prodhuar në 75 vite i ka kapërcyer 15 milionë ton, (duke konsideruar vlerën e mineralit, me një çmim mesatar në vite prej 200 dollarë toni, rezulton një vlerë prej rreth 3 000 000 000 (3 miliard) dollarë, këtu një rol dominant ka patur dhe ka Fabrika e pasurimit si gjeneruese kryesore e prodhimit.

Por Ing.B.Koçi pohon se rënia e shpejtë e nivelit të prodhimit që filloi në vitin 1988, u thellua me ndërrimin e sitimeve. “Nuk po shtoheshin më rezervat e mineralit të kromit, puntorët po iknin në emigracion, nivele të rinj prodhimi nuk po hapeshin. Zgjidhja u mendua tek dhënia me koncesion në investitorë të huaj, por prodhimi sërish nuk u ngrit, përkunder ra më poshtë. Pa punë mbeti edhe Fabrika e Bulqizës, e ndërtuar për pasurimin e kromeve të varfëra. Fabrika e pasurimit të kromit e Bulqizës, e para e këtij lloji në vendin tonë, është vënë në punë në vitin 1973. Ajo përpunonte në koncentrate kromi pluhurat e mineralit të pasur dhe kromitet e varfëra. Dhe ja: I mbeti vetëm emri! Mall pa zot siç thuhet në këto raste. Gati një skelet -fabrike nga grabitjet e hekurit e makinerive”, -shprehet Ing.B.Koçi në intervistën për këtë film.

Në shtator të vitit 2001 inxhinieri bulqizak Bukurosh Koçi u tregua iniciator, i guximshëm, vizionar dhe shpresëmirë. Në kuadër të privatizimit plotësoi dokumentacionin e duhur, bindës për perspektivën dhe e privatizoi këtë objekt që i dhimbte në zemër tek e shikonte karakterin. Se inxhinier Bukuroshi është rritur në mjedis familjar, ku miniera ishte jeta, kryebiseda e prindërve dhe të afërmeve. Disa vite kishte punuar në këtë miniere, kështuqë përvoja e punës e ndihmoi për ta ringjallur shpejt fabrikën. Brenda vitit e vuri në funksionim.

Punësoi mbi 80 punëtorë. Prodhimi u rrit. Nisi dërgimi i mineralit të përpunuar për eksport. Ringjallja e fabrikës zbuti varfërinë, mundësoi një mirëqenie normale në mbi 80 familje të zonës. Kështu inxhinier Bukurosh Koçi, i aftë, me vizion për perspektivat e fabrikës është sot ndër më të suksesshmit në zonën e Bulqizës dhe madje edhe në rang kombëtar.

Në intervistën për filmin “...E nderit është nëntoka

e Bulqizës...” ai flet për ringjalljen e fabrikës së pasurimit të kromit, investimet e kryera, teknologjitë e avancuara që aplikohen, si dhe materialin që vetë fabrika prodhon.

T’ia nisesh nga e para. Por duhet të dish kur është momenti për t’ia nisur e çka është më me rëndësi të mos ndalesh nga vështirësitë. Ky është stili i punës, i metabolizuar në shpirtin kërkues dhe novator të inxhinier Bukurosh Koçi. Në bashkëpunim me një kompani tjetër, fabrikës së pasurimit të kromit në Bulqizë iu bashkëngjiti e privatizuar një ish fabrikë e vjetër e pasurimit të kromit në Gjakovë. E lënë në mëshirë të fatit. Me afro 1.5 milion Euro investime kjo fabrikë u riaktivizua. Në të përpunohen minerale të zonës kufitare, kryesisht të Hasit dhe Tropojës. Paisjet janë të standarteve bashkohore, suedeze dhe kineze. Investimet vazhdojnë në këtë fabrike. Staf e punonjës të kualifikuar. Paga të kenaqshme. Uke Koçi, inxhinier prodhimi në këtë fabrikë dhe punëtorë kosovarë që punojnë aty pohojnë në këtë film se investimet në sektorin e minierave po rriten si rruga e vetme që sheh biznesi privat për shtimin e prodhimit edhe pse shteti ende nuk po e gjen veten në zbulimin e rezervave të mineraleve që i shërbejnë fuqizimit të kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë.

Një moment tjetër emocionues në këtë fil është industria e kromit në Kukës, pothuajse e shuar prej vitesh, e shfrytëzuar në mënyrë të jashtëligjshme dhe e degraduar nga makateria, por që nga viti 2014 u gjallërua. Sërish sipërmarrësi, inxhinier Bukurosh Koçi, në bashkëpunim me investitorë seriozë të huaj i kthyen sytë nga kjo miniere. Është një investim shqiptaro-austriako-suedeze. Në fabrikë është instaluar teknologjia më moderne, e cila perdor një metodë nga më të suksesshmet, që ka përparësi mbrojtjen e mjedisit. I gjithë uji i fabrikës shkon në qark të shkurtër. Nuk përdoret asnjë lloj kimikati dhe nuk ka rrjedhje.

“Nisi shfrytëzimi me kriter, me teknologji bashkohore për daljen në sipërfaqe të materialeve të fjetura. Miniera e kromit në Kalimash, sipas studimeve të kryera, ka rezerva industriale prej afro 1,23 milion ton krom!!! Investimet e kryera rezultojnë që kapaciteti përpunues i fabrikës është afro 40000 ton në vit mineral i pasuruar dhe koncentrat kromi. Në këtë fabrikë, ku faza e parë e investimit kap vlerën prej 3,5 milionë euro, janë punësuar deri tani mbi 150 punonjës”, -pohon Ing.Bukurosh Koçi

## PROFILE DREJTUESISH QË FRYMËZOJNË

(Vijon nga faqja 7)

“Ai jetësoi punën e tij për kromin e markës shqiptare”, shprehen ndër kujtime ish punëtorët dhe koleget e tij të minierës. Në respekt për këtë inxhinier - ikonë ndershmërie e përkushtimi ndaj punës, miniera mban emrin e tij: MINIERA E KROMIT “TODO MANÇO”, Bulqizë!”

Të mirat dhe fajet thuhet se i mban mend ndërgjegja. Shpesh në jetë njerëzit harrojnë ato që thua, ato që ke bërë...por kurrë nuk harrojnë mënyrën se si i ke bërë të ndihen.

**Martin Cukalla** edhe sot kur shkon në minierën e Bulqizës duket sikur dje është larguar prej saj. Në film jepen çaste se si ai rrethohet nga respekti e mirënjohja e njerëzve aty. Dhe kjo është lumturi. Në botë vijnë me asgjë, largohemi prej saj pa marrë asgjë, dhe i lumtur është ai që ka lënë një kujtim në mendjen dhe në zemrën e dikujt. Martin Cukalla është një tjetër drejtues i aftë e i drejtë që kerkonte të vërtetën.

Njerëzit e respektojnë, se ai gjithnjë i ka dashur dhe respektuar. Një buzëqeshje apo shtrëngim dore me njeriun e thjeshtë asgjë nuk na kushton, por atij që ia jep e lumturon, pa varfëruar atë që e jep.

**Hamza Gurra** është një nga inxhinierët që jetën e tij e ka të lidhur me minierën. Mbi 50 vjet ka jetuar në qytetin e vogël të Bulqizës. Përvoja profesionale, gadishmëria dhe ndërgjegjja e tij në punë janë shembull i gjallë në kujtesën e njerëzve me të cilët ka punuar. Një shpirt i bukur artistik që, siç tregojnë shokët e tij, hynte galerive të minierës me arie të Bethovenit, Vivaldit në gojë...“Ti je artist” i thoshin shokët. -Artist je kur çdo punë e bën me pasion gjegjej ai”.

**Fatmir Beqiri** kujtohet si inxhinieri i vlerësuar për aftësitë e tij organizative e teknike, njeri që nuk përtonte e që ishte thujtë çdo çast në galeri e pranë minatorëve dhe i ndëshkuar padrejtësisht nga goditjet që vinin nga lart. Kurrë nuk u thye ai njeri, përkundër u ngrit sërish e më i nderuar në krye të punëve e të sakrificave dhe meritoi respektin e kolegëve e të minatorëve në detyrat e ngarkuara si kryeinxhinier e drejtor i minierës veriore.

Artistikisht pasqyrohen në filmin “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...” edhe një brez i ri inxhinierësh që mbartën mbi shpatullat e tyre përgjegjësitë e mëdha të organizimit të punëve e të rritjes së pandërperë të nxjerrjes së kromit. Përmenden këtu **Shefqet Klllogjeri e Jani Pasko, Vehbi Musta e Fadil Cami, Gezim Dauti, Bukurosh Koçi** e dhjetra të tjerë.



# NË FABRIKËN E PASURIMIT TË KROMIT PUNOHET DHE MENDOHET GJITHNJË PËR PERSPEKTIVËN

Në fabrikën e pasurimit të kromit në Bulqizë punohet dhe mendohet gjithnjë për perspektivën, përsosjen e standardeve. Investime të herëpashërshme në reparte e paisje. Në filmin "...E nderit është nëntoka e Bulqizës..." jepen çaste pune në laboratorë bashkëkohor fiziko-kimik, që përpunojnë gjithë monstat e lëndëve të para që futen në këtë fabrikë (lëndët e para që futen në këtë fabrikë, por dhe monstat e prodhimit përfundimtar të saj, koncentratit të kromit). Çdo ditë, kamionë me "ARIN GRI" shkojnë drejt Portit të Durrësit. Vende të ndryshme të Europës e më gjerë vlerësojnë kromin e Bulqizës. Pasuri shqiptare që ndërkohe i sjell buxhetit të shtetit të ardhura të konsiderueshme.

Ing. Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për "njolla në biografi" sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapa-



surimin e mineraleve të kromit në Tërrnovës, Kukësit, Tropojës, Hasit zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, etj, si dhe bashkpunëtor në kryerjen

e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë; po ashtu autor dhe bashkautor i ndërtimit të disa Fabrikave e impianteve për pasurimin e mineralit të kromeve të varfëra, si dhe i disa rikonstrukcione Fabrikash Pasurimi, ka ngritur e konsoliduar një Shoqëri nga e cila janë përpunuar dhe vazhdojnë të ripërpunohen mbi 2.5 milion ton sterile dambe, duke prodhuar koncentrat kromi për eksport. Sot në këtë shoqëri që po mbush afro 23 vjet, punojnë rreth 100 punonjës të profesioneve teknologë, mekanikë, elektrike, manovratorë e shoferë. Ai shprehet për përfshirjen më të gjerë të shoqërisë, jo vetëm në përpunim por dhe prodhim të lëndës së parë, qoftë dhe për kromite të varfëra, duke vërejtur se sasia e sterileve që mund të riciklohet po shkon drejt përfundimit, ndaj orientimit të ri të shoqërisë dhe drejt objekteve të reja të shfrytëzimit të kromit apo dhe kërkim-zbulimit të trupave të rinj minerare.

## FAMILJA KOÇI, NJË NDËR ATO QË I KA DHËNË SHUMË MINIERËS

Për ta bërë sa më jetësor filmin, skenaristi Cukalla dhe regjisorit Pepo kanë bërë pjesë të qënësishme të tij edhe Familjen Koçi të Bulqizës, një ndër familjet e këtij qyteti, apo të zonave përreth që i ka dhënë shumë minierës. Madje, po të bësh apel njerëzit e kësaj familjeje që kanë kontribuar me vite e dekada në miniere...bëhen gati një brigadë e tërë.

Filmi tregon për Hasan Koçin që ishte njëri nga minatorët e prodhimit, i mirënjohur në gjithë minierën, për Qemalin dhe Dilaverin që shquheshin si minatorë të punimeve minerare. Po ashtu flitet për Hysenin që ishte gjithnjë i gatshëm të paraqitej ku të ishte nevojua: në prodhim apo punime minerare. Flitet edhe për Sabriun që ka qenë brigadier. Të gjithë kanë dalë në pension si punëtorë miniere.

Ndërsa ISUF KOÇI, nuk harrohet kurrë. Në këtë film ai pasqyrohet me foto e pamje filmike si drejtori që drejtoi me zotësi dhe solli veç të mira për njerëzit si drejtues i bujqësisë dhe themelues i fermës në Fushë Bulqizë. Populli i Bulqizës e ka përjetësuar në memorin e tij Isufin. Edhe në këtë dokumentar, si edhe, në oda burrash, evente e takime, pohohet se djalë si Ai, nuk i vjen më Bulqizës. Po. Ai ishte dhe mbetet simboli i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale, mishërues dhe përçues i mençurisë dhe urtësisë dibrane. Këto virtyte e shoqëruan si kuadër dhe drejtues shembullor, qoftë në ish - kooperativën bujqësore dhe në Fermën e Fushë Bulqizës, të cilën e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm deri në fundin e sistemit monist. Filmi dokumentar i regjisorit Pepo sjell shembuj që kur drejtonte Isuf Koçi, kooperativa dhe ferma patën nivelin më të lartë të zhvillimit të të gjitha kohërave.

Në atë shtëpi karakteristike dibrane, Hajdar Koçi prezantohet si një tjetër pjestar i familjes së madhe Koçi. Një shtegtar i veprave të ekonomisë shqiptare që ka punuar në hidrocentralet e para, si në atë të Selitës, Ulzës etj. Më pas filloi punën në minierën e Bulqizës si mekanik i minierës, përmbi 30 vite, deri sa doli në pension.

Nga gjiri i kesaj familje tregohen në film dhe një skuadër djemsh e burrash të rinj në moshë, që punojnë në minierë apo në Fabrikën e Pasurimit të mineralit, si Hazizi, Ruzhdiu, Xhevahiri, Uka, Inxhinier BUKUROSH KOÇI, që është sot sipërmarrës i Fabrikës së Pasurimit të kromit në Bulqizë. Është vërtetë impresionuese intevsita e tij në këtë film.

## BULQIZA ME RESURSE TË SHUMTA TURISTIKE DHE NJERËZ TË FAMSHËM

Në filmin e regjisorit Pepo, Bulqiza nuk jepet vetëm si vendburimi kryesor i kromit, por edhe me atraksionet e shumta turistike. Sepse mjaftë njerëz guximtarë dhe me vizion duan te çojnë edhe ne udhën e turizmit, sidomos tani me avantazhet e rrugës së "Arbërit", kur Bulqiza mund të konsiderohet si një lagje e Tiranës, duke ju afruar miqve dhe të huajve bukuritë natyrore, liqenet malorë të Dhoksit e Durricit, nga më të bukurit e Shqipërisë, pyjet me klimën e tyre të shëndeteshme, pishat përherë të gjelbërta, duke dashur t'ju krijojnë kushte sa më të mira për të kaluar ditë të paharruara.

Me plane dhe vizion ambicioz mbresëlënës prezantohet në film edhe një djalë i guximshëm i Bulqizës, që dëshiron të ngrejë një resort të bukur turistik buzë liqeneve.

Vend meritore ka në këtë film edhe Edmond Isaku, i mirënjohur në Bulqizë, pasi ka hapur hotelin "Bulqiza", një ndër më luksozët dhe më të rehatshmit në vend.

Këtu është edhe stacioni televiziv "TV Bulqiza", për të cilin Mondi tregon një kujdes të veçantë. "TV Bulqiza" transmeton programe të bukur njohëse dhe historike për bashkëqytetarët, duke ju rritur dijet dhe dashurinë për vendlindjen e tyre. Njerëz të shquar me famë në të gjithë botën, ka nxjerrë Bulqiza. Të tillë janë vellezërit Keta, këta kampionë botërorë në artet marciale, që realizuesit e këtij filmi i gjetën

në Mynih të Gjermanisë. Ata kanë hapur një shkollë të arteve marciale, ku njerëz të njohur e të rëndësishëm të jetës gjermane, vinë këtu rregullisht. Ata na tregojnë:

Vëllezërit kampionë Ismail, Gjetan e Ferit Keta nuk i harrojnë kurrë rrënjët, Bulqizën e dashur me prindërit dhe gjyshin e shtrenjtë

Dhe ja në fund të filmit, përsëri takimi i brezave. Kujtime të njerëzve, që një pjesë të rëndësishme të jetës së tyre e lidhën me minierën. Këto kujtime, apo librat me kujtime shkruar modestesisht, janë një testament shpirtëror që brezat e minatorëve i lenë njeri-tjetrit.

Kujtime të bukura, kujtime të dhimbshme e nderim për heronjtë që ndër vite dhanë jetën në minierë. Por ajo që dhemb edhe më shumë është kur ndjehen të harruar në indiferencën e kaosit të realitetit shqiptar, të qeverive shqiptare njëra pas tjetrës. Këta minatorë fisnikërisht kërkohen të drejtën e tyre themelore, hartimin sa më shpejt të Ligjit për "STATUSIN E MINATORIT". E drejta e tyre gati bërtet!

Indiferenca dhe korrupsioni, sado të mëdha nuk do mundet ta mbytin zërin minator. Ky zë mbetet peng i tyre... Ndaj edhe ky film është dëshmi se minatorët nuk e humbin shpresën. Shpresa, një fjalë që gjendet me ta në mëngjes, ndofta vritet nga shurdhëria gjatë ditës, por fatmirësisht rilind me agimin!. Edhe pse nëntokë, si në çdo gjë, drita e gjen rrugën!...



Kryetari i Komunës Podujevë z.Shpejtim Bulliqi, vlerësoj përpara pjesmarrësve, figurën e ekonomistit llapjan Xhemshit Duriqi dhe pershëndeti grupin e vizitorëve bulqizakë që morën pjesë në këtë përkujtim. Ai tha se është me rëndësi të kemi bashkëpunim e shkëmbim përvojë, Komuna Podujevë me Bashkinë Bulqizë, duke realizuar marrëveshje binjakëzimi në një kohë të përshtatëshme.

homazh

# RESPEKT E MIRËNJOHJE PËR RRËNJËT TONA



Më 4 korrik 2023 një grup me anëtarë të fisit Duriqi nga Bulqiza, të fisi Duriqi në Obrançë, Podujevë dhe përfaqësues

të Këshillit të Bashkisë Bulqizë dhe të kryesisë "Shoqatës Bulqiza" kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule të freskëta dhe një grusht dheu nga toka e Bulqizës. U mbajt një minutë heshtje në vendin e prehjes të ish profesorit dhe ekonomistit të njohur llapjan, Xhemshit Duriqi, në 4 vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. Mbetet e paharruar pjesmarrja e Bacës Xhemshit bashkë me nipin e tij Fitim Duriqi në ceremoninë

e vendosjes së monumentit të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit në Fushën e Vajkalit dhe përshtatësia e tij e ngrohtë për pjesmarrësit në atë rast, në maj 2017.

Kryetari i Komunës Podujevë z.Shpejtim Bulliqi, vlerësoj përpara pjesmarrësve, figurën e ekonomistit llapjan Xhemshit Duriqi dhe pershëndeti grupin e vizitorëve bulqizakë që morën pjesë në këtë përkujtim. Ai tha se është me rëndësi të kemi

bashkëpunim e shkëmbim përvojë, Komuna Podujevë me Bashkinë Bulqizë, duke realizuar marrëveshje binjakëzimi në një kohë të përshtatëshme.

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Bulqizë, kryetari i "Shoqatës Bulqiza" dhe të gjithë bashkëbiseduesit e mbështetën e vlerësuan propozimin e z.Shpejtim Bulliqi.

Gjen. Lejt. Kadri Kastrati theksoj në fjalën e tij, se marrëdhënjet vëllazërore e vizitat na bëjnë krenar të mësojmë mirë historinë me sakrificat të mëdha të popullit tonë, duke vlerësuar njerzit e shquar dhe dëshmorët që derdhën gjakun për lirinë që gëzojmë ne sot. Më pas e mori fjalën z.Bashkim Lami, i cili tha, se grupi i përfaqësuesve nga Bulqiza dhe fisi Duriqi, ndjehemi sot shumë të emocionuar, që po vendosim një grusht dheu e lule të sjella nga Bulqiza, në vendin ku prehet ky burrështetas, që me punët e shembullin e tij meriton nderimet më të larta. Ai shprehu vlerësimet për arritjet e Xhemshit Duriqit në të gjallë të tij dhe u dorëzoi familjes "Duriqi", ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE nga Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" për XHEMSHIT ABDYL DURIQI (pas vdekjes) Me motivacionin: Për vlerësimin e jetës e punës së tij si atdhetar e burrështetas fisnik e i mënçur, që ka lënë kujtime të paharruara në detyra të larta shtetërore, si ekspert i shquar ekonomie. Ka mbështetur me gjithë familjen e fisin "Duriqi" luftën për çlirimin e Kosovës dhe evidentimin e dëmeve në këtë luftë. Njeriu i këshillave të urta nga mendja e tij e ndritur, aktivist e familjar shembullor, që do të kujtohet përherë për pasionin, dashurinë e kontributin ndaj Atdheut." Vendimi mban nr 73 dt 30.06.2023. Djemt e Xhemshitit, Avdyli e Artani falenderuan e shprehën mirënjohjen e tyre me këtë rast për të pranishmit, që morën pjesë në homazh për katër vjetorin e ndarjes nga jeta të babait të tyre, si dhe nderimi që ju bëhet. Grupi vizitor e vendosi lule edhe ne memorialin e dëshmorëve të fisit Duriqi që u masakrua nje familje 7 anëtarëshe me katër fëmijë të vegjël.

Dëshirojmë të falenderojmë përzemërsisht kryetarin e Komunës Podujevë z.Shpejtim Bulliqi dhe të gjithë ata që e shoqëronin Gjen. Lejt. Kadri Kastrati, Prof. Dr. Ali H. Hamiti, Selim Haziri bashkëluftëtarë i Zahir Pajazitit dhe djemtë Abdyl & Artan Duriqi, të cilëve me këtë rast ju jemi falenderues e mirënjohës për mikpritjen, respektin e bujarin në takim me grupin vizitor nga Bulqiza, që bashkërisht kryem homazhe.

**Me respekt e mirenjohje  
Bashkim Lami  
Obrançë, Podujevë**

## Hidhet shtresa e dytë asfaltike në Rrugën e Arbrit në fshatin Plani Bardhë

10 Korrik, 2023- Kompania që po ndërton rrugën e Arbrit ka vijuar punën me hedhjen e shtretës së dytë asfaltike në segmentin nga Qafa e Buallit në drejtim të Urës së Vashës.

Përreth 1 javë ky aks rrugor ishte i bllokuar për qarkullimin e automjeteve në drejtim të Peshkopisë, Bulqizës e anasjelltas, ndërsa për momentin lëvizja është rikthyer.

Siç duket nga pamjet, shtresa e dytë asfaltike është hedhur deri në afërsi të tunelit të vogël pranë Urës së Vashës, në të gjithë trasenë e rrugës. Ndalimi i lëvizjes është bërë për këtë arsye që e gjithë traseja të shtrohet në të njëjtën kohë.

Ndërkohë, paralelisht vijon puna edhe për veshjen e skarpatave të këtij segmenti nga Ura e Vashës në drejtim të Qafës së Buallit, një investim ky shtesë në fondin e rrugës së Arbrit e fituar nga një tjetër kompani.

Burime pranë firmës thanë se pritet të sigurohet sasia e mjaftueshme e asfaltit në mënyrë që të vijojë më tej shtrimi i pjesës tjetër të rrugës nga Plani i Bardhë në drejtim të fshatit Fshat.

Rruga e Arbrit vijon të jetë një kantar ndërtimi pasi asnjë metër e saj nuk është ndërtuar përfundimisht, ndërkohë që vepra më e rëndësishme është tuneli i Murrizit i cili ende nuk është hapur./bt-  
vnews.al



# Beteja e Dibrës, 3-11 prill 1941




NGA SAKIP CAMI

**C**itojmë në fillim variantin e Gian Carlo Fuscos: “Beteja e Dibrës e prillit 1941, ndonse e lënë në heshtje nga historiografia zyrtare shqiptare dhe më gjërë, u zhvillua nga 3 deri më 11 prill të vitit 1941 në luginën e Drinit, në zonën ndërmjet Zerqanit dhe qytetit të Dibrës.

Kjo luftë shkaktoi jo vetëm me qindra të vdekur nga të dy palët, italianë dhe jugosllavë, por shkaktoi dëme të shumta në njerëz e materiale ndër popullsinë shqiptare këtë e andej kufirit.

U zhvillua me urdhër të Musolinit vetëm për t’u treguar gjermanëve se sa i aftë është ai dhe ushtria e tij edhe pse ushtria gjermane po marshonte nëpër



(HARTA E MARRË NGA LIBRI ITALIAN) ( GIAN CARLO FUSCO, GUERRA D’ALBANIA )FAQE 88-90, MILANO, 1977

Jugosllavi me ritme të përshpejtuara dhe pa hasur asnjë pengesë.

Me urdhër të Musolinit me 1 prill

1941, Divizioni Italian “Cuneense” që po organizohej për të sulmuar Këlcyrën, u transferua me urgjencë në Zerqan, me

objektiv zyrtar për të mbyllur luginën e ngushtë të Zerqanit në rast sulmi nga ana jugosllave drejt Tiranës. (Linja blu e hartës). Me 3 prill trupat italiane të këtij divizioni, batalionet “Pieve di Teco” me makina dhe “Ceva” e “Mondovi” në këmbë mbërritën në Zerqan.

Me 8 prill 1941, dy ditë pasi Gjermania i kishte shpallur luftë Jugosllavisë dhe po marshonte kudo pa hasur rezistencë, trupat italiane të sapo ardhura së bashku me divizionet “Firenze” dhe “Puglie” u vendosën në formacione luftimesh në formë pince (dare) nga Qafa e Prevallit e deri në Pocest.

Me 9 prill trupat italiane të ndara në dy kolona, njëra nga veriu e tjetra nga jugu marshuan drejt qytetit të Dibrës. (2 linjat e kuqe të hartës).

Kushtet klimatike shumë të këqija, reshje të shumta dëbore, acar dhe mjegull e dendur që pengonte shikimin, vështirsonin tej mase ecjen përpara.

Ndonse trupat gjermane ndërkohë kishin marrë qytetin e Prilepit, vetëm 85 km në vijë ajrore në lindje të qytetit të Dibrës dhe po marshonin pa pengesë drejt qytetit të Dibrës nga lindja, trupat italiane për 2 ditë mbetën të bllokuara nga ushtria jugosllave dhe zjarri i artilerisë dhe nuk arritën të bënin asnjë hap përpara. Me 11 prill 1941, me kapitullimin e ushtrisë jugosllave nga ushtria gjermane dhe ndërprerja e luftimeve, ushtria italiane mundi të hynte në qytetin e Dibrës.

2 ditë luftime të kota, thjesht nën moton e Duçes “ Do i theyjmë kokat armikut dhe do i tregoj Hitlerit se kush është ushtria italiane!” Ushtria Italiane e përgjysmuar dhe e demoralizuar pas 6 muaj humbesh me ushtrinë greke, i shpalli luftë Jugosllavisë, duke sulmuar në Dibrë dhe në Koplik. Në Koplik u theye dhe trupat jugosllave arritën deri në Vrakë dhe rrezikuan Shkodrën, kurse në Dibrë nuk bënë asnjë hap përpara, por rrezikuan thyrjen dhe lënien e lirë të rrugës për Tiranë.

Përparimi në mënyrë të përshpejtuar i ushtrisë gjermane nga Prilepi në Dibrë të madhe, solli kapitullimin e trupave jugosllave dhe shpëtoi italianët nga thyerja e plotë.” Sikurse duket nga harta, vijat e kuqe, divizioni pasi përqëndrohet në Zerqan, marshon në dy krahë, të majtë dhe të djathtë që synojnë Dibrën e madhe. Brenda kësaj dare janë fshatrat Strikçan, Lubalesh, Viçisht, Pasinkë, Çerenec, Shupenzë, Topojan, Bllatë e epërme, Maqellarë.

## Aksioni luftarak i prillit 1941, kundërveprimi ndaj fashistëve, dëshmorët e parë

(Nga libri im “Lufta Nacional Clirimitare në Dibër, faqe 155-156)

**N**ë ditët e para të prillit, italianët shtrinë forcat e Divizionit “Firenze” në vijën Maqellarë-Shupenzë-Miresh-Klenjë e deri në Librazhd. Në brezin e dytë që fillonte nga Smolliku në Strikçan-Zerqan-Fushë-Bulqizë-Mali i Bllacës-Katër Grykët qe vendosur Divizioni Alpin “Brenero”. Atdhetarët dibranë bënë planin për t’u nisur në dy drejtime: Haxhi Lleshi, Ahmet Cami dhe Ymer Lleshi me 200 veta u nisën në krahun Sebetovë, Tërbaç, Çerenec, Viçisht. Aqif Lleshi me Hamdi Lleshin me 100 pushkatarë në Bllatë, Reshan e Maqellarë.

Siç shkruhet në krye të hartës, at-


dhetarët dibranë me insistimin e tyre luftuan kundër trupave fashiste në vijën Miresh, Sepetovë, Vicisht, Çerenec, Bllatë, Kilopcisht.

Më 6 prill filluan veprimet luftarake dhe në befasi të plotë u morën postat kufitare të Ostrenit, Mireshit e Viçishtit dhe erdhën deri në kodrat e Gjoricës. Forcat e komanduara nga Aqif Lleshi morën postën e Bllatës. Gjatë luftës u bashkuan shumë fshatarë me luftëtarët kundër pushtuesve. Armiku la shumë të vrarë e të plagosur, sidomos në Miresh ku u godit një batalion i Divizionit Firenze dhe u vranë 50 oficerë dhe ushtarë italianë,

u zunë shumë armë, municione, veshmbathje, e ushqime që ju shpërndanë luftëtarëve.

Ranë dëshmorët e parë Abdurahim Lleshi e Vebi Jashari në Zonën e Maqellarës. Në kodrat e Çerenecit u vra mësuesi patriot Fasli Cami duke kryer detyrën e korierit. Më vonë italianët vranë Musa Camin, Ejup Camin e Mexhit Lezin. Mbetën të plagosur Sefer Prapaniku nga Prapaniku dhe Xhelo e Hysen Jashari nga Kovashica. (LANÇ në Dibër Faqe 388). Pas kapitullimit të Jugosllavisë, Italia fashiste dërgoi forca të mëdha në Dibër të Madhe. Ku filluan raprezaljet, internimet e masat e tjera shtypëse kundër luftëtarëve që përgjakën ushtritë pushtuese më 6 prill. Në këto kushte u bë e vështirë lëvizja prej 300 e ca vetësh, prandaj ato u shpërndanë pranë familjëve me qëllim që të vazhdonin veprimtarinë antifashiste në forma të ndryshme. , të gatshëm në kohën e riorganizimit, të kujdesshëm edhe ndaj mashtrimeve. Në pabesi” burgosën Ahmet Camin, disa Came të tjerë, Murat Bashën, Sali Llanin, Jashar Lelën, etj. Pëllumb Lleshin, Lutfi Lleshin, Shaqir Skukën, Nuz Majtarën i zbuluan dhe i internuan në Peqin, Kavajë e gjer në Itali”. (Haxhi Lleshi ,Vite, Njerëz, Ngjarje, Tiranë, 1996 fq 43).

Autori italian e quan këtë luftë një luftë të kotë, një kapricio të Musolinit, por lufta e beteja të kota nuk ka sepse vriten njerëz e ushtarë nga të dyja palët. Dibranët i mbrojtën me gjak trojet e tyre, ndonëse të pakët në numër e me armatim të pakët.



(HARTA ËSHTË MARRË NË MUZEUN HISTORIK TË DIBRËS)

Qytetarët kanë nisur të marrin frytet e para të këtij projekti të jashtëzakonshëm infrastrukturor

inspektimi

# Me “Rrugën e Arbrit”, Bulqiza si “Iagje e Tiranës”

Qytetarët e Bulqizës, si edhe gjithë dibranët këndej e matanë kufirit (në Bllatë) i gëzojnë si askush tjetër avantazhit që ka sjellë për ta ndërtimi i Rrugës së Arbrit. Duke i afruar vetëm një orë larg Tiranës bulqizakët e ndjejnë veten si në një lagje të metropolit shqiptar.

Bulqizës, tashmë i janë shtuar shanset për zhvillimin e turizmit. Turistë, të shumtë, jo vetëm vendas por edhe nga Europa, gjermanë, danezë, polakë etj, po shijojnë atraksionet turistike të kësaj zone. Pasi kanë udhëtuar që në mëngjes herët me mikrobuzë, një grup të rinjsh polakë, me çantat në sipinë kanë udhëtuar drejt liqeneve të Dhoksit. Të mahnitur nga bukuria e këtyre liqeneve mes malesh me pyje të larta e të dendura, ata shprehen se do të vijnë këtu edhe herë të tjera.

Më vënien në shfrytëzime edhe të segmentit nga Ura e Vashës në Qafë të Buallit, Rruga e Arbrit ua ka lehtësuar shumë lëvizjen drejt kryeqytetit dhe anasjelltas qytetarëve të Bulqizës, por edhe turistëve të shumtë.

Për dy orë vajtje-kthim na është mundësuar furnizimi me të gjitha mallrat që marrim nga Tirana, thotë një tregtar bulqizak i shitjes së mallrave me shumicë. Por edhe qytetarë të thjeshtë nuk e fshehin kënaqësinë, kur thonë se tashmë u është mundësuar edhe vajtja në plazhet ditore të Durrësit e Gjirit të Lalëzit. Po ashtu edhe shoferët e furgonëve taksi që e bëjnë këtë rrugë dy-tre herë në ditë.

## BALLUKU: TUNELI I MURRIZIT NË 400 METRAT E FUNDIT, POR NUK JAPIM AFATE PËR MBARIMIN

“Ecuria tani është konstante dhe ka rëndësi që të përfundojë hapja e tunelit. Ne sërish nuk do të japim afate për tunelin e Murrizit, pasi ky është rast, që siguria rrugore, çështjet e sigurisë në të ardhmen, janë shumë më të rëndësishme se dëshira për të mbaruar sa më shpejt”.

“Puna në tunelin e Murrizit po vijon. Janë metrat e fundit që edhe kjo vepër, më e rëndësishmja e Rrugës së Arbrit, të jetë plotësisht e hapur dhe e aksesueshme për të gjithë drejtuesit e automjeteve. Gjeologjia solli vonesat në ecurinë e këtij projekti, por puna nuk është ndalur dhe nuk do të ndalet deri në përfundimin dhe hapjen e plotë të tunelit, i cili bën të mundur që i gjithë qarku i Dibrës të jetë akoma edhe më afër me Tiranën”, shkruante me datë 30 maj 2023 në profilin e saj në Facebook znj. Belinda Balluku, zv. kryeministre dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Më datë 29 maj 2023, Balluku, e shoqëruar nga z. Evis Berberi, Drejtor i Përgjithshëm i Autorite-



**Znj. Belind Balluku (në mes) deke inspektuar punimet brenda galerive të Tunelit të Murrizit**

tit Rrugor Shqiptar si dhe punonjës të kompanisë “Gjoka ‘87”, inspektuan punimet në tunelin e Murrizit, duke e përshkruar në këmbë dhe në makinë të gjithë gjatësinë e tunelit, si dhe duke sjellë për herë të parë para publikut një video mbi ecurinë e punës dhe problematikat e shfaqura. Videoja prej 30 minutash u publikua në Facebook-un e ministres së Infrastrukturës, e cila, së bashku me drejtorin e ARRSH u munduan të japin sqarime për të gjitha vonesat e deritanishme në grafikun e punimeve në tunelin e Murrizit, duke e lidhur këtë me problemet gjeologjike të paparashikuara.

### “PUNA NË TERREN NË DISA FRONTE”

“Ashtu siç e kemi premtuar, për të bërë një inspektim edhe për të informuar qytetarët, të cilët tashmë me përfundimin e pothuajse gjithë segmenteve të Rrugës së Arbrit, janë shumë të interesuar për të ditur ecurinë e këtij tuneli, i cili ka nisur në 2018, por për shkak të gjeologjisë shumë komplekse që kemi pasur këtu, na është dashur që të përballemi me situata që sigurisht kanë marrë më shumë kohë nga sa ishte parashikuar”, tha Balluku ndërkohë që po hynte në galerinë kryesore të tunelit të Murrizit në hyrjen nga Tirana.

Tuneli i Murrizit ka dy tuba kalimi, të gjatë 3.78 km secili, të cilat lidhen përmes tyre me 11 tunele bashkuese.

“11 tunelet bashkuese janë të gjitha të hapura ashtu siç është edhe tuneli i emergjencës i gjithi i hapur”, – tha Balluku.

Duke folur për punimet brenda tunelit, Evis Berberi tha se “në tunelin e emergjencës janë betonuar 650 metra dhe vazhdohet me ritme të mira për ta çuar deri në fund betonimin”, ndërsa në tunelin kryesor betonimi ka ecur më shpejt. Sipas tij, nga dy kantieret e ngritura në dy anët e tunelit “janë betonuar nga 1.1 km në secilën anë, në total 2.2 km, ndërsa është duke u punuar në

400 metrat e fundit në tunelin kryesor”. Berberi la të kuptojë se, meqë puna vazhdon në të dy frontet, tuneli avancon çdo ditë nga 3 metra.

Balluku gjatë vizitës në kantier tha se “është kënaqësi të shikosh se ka fronte të hapura gjithë kohën, duke filluar nga të gjitha makineritë dhe punëtorët, të cilët kryejnë procese të ndryshme nga gërmimi tek armatimi, tek ankorimi dhe gjithçka tjetër, dhe kjo është diçka që ne duhet ta themi”.

“Tuneli do të ketë dy korsi lëvizje me 3.75 metra si dhe trotuare me gjerësi 1.5 metra. të kombinuara me 11 galeritë lidhëse me tunelin e emergjencës. Parashikohet që trafiku në tunel të mos bllokohet asnjëherë, sepse nëse ndodh një defekt në mjete apo ndonjë aksident, ekziston mundësia të nxirren në anë të rrugës pa e bllokuar trafikun”, tha Berberi.

Punimet në brendësi të Murrizit janë komplekse dhe sipas drejtorit të ARRSH “janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe vazhdojnë si me betonimet, gërmimet e transportin ashtu dhe me hapjen e themeleve”.

“Ne kemi bërë gati dhe porositë për pajisjet elektromekanike, pasi është një tunel i gjatë dhe pajisjet elektromekanike janë duke u prodhuar specifikisht për këtë tunel”, tha Berberi.

“Kur do të takohen të dyja portalet për të parë dritë në krahun tjetër, do të jetë një moment që ne do ta bëjmë live, ashtu siç kemi bërë dhe Llogoranë dhe Kardhiqin, për t’ua treguar të gjithëve, pasi do të jetë një moment shumë i rëndësishëm, duke qenë se Rruga e Arbrit është një nga arteriet më të rëndësishme të vendit tonë”, tha Balluku.

Balluku dhe Berberi nuk preferuan të japin afate për hapjen e galerisë kryesore, por duke pasur parasysh ecurinë e punimeve të fundit, besohet se në fund të shtatorit apo gjatë muajit tetor, dy tunelet të bashkohen, duke u hapur plotësisht si galeri drite.



# Peladhia – fshati magjik rrëzë Temlës, katund i arsimtarëve dhe trashëgimisë historike

DR. ADRIATIK BALLA

Sot do t'u njohim me një fshat të veçantë, Peladhinë, që shtrihet në qarkun e Dibrës, në Bashkinë Bulqizë.


Peladhia është pjesë e njësisë administrative të Grykës së Madhe, njohur sot si Zerqani. Është një nga 13 fshatrat e kësaj njësie, pozicionuar në anën VP, në luginën e Zallit të Bulqizës dhe njësinë malore kufizuese në veri të saj.

Peladhia shtrihet nga ura e Qytetit në JP e deri në kufi me fshatin Godvi në lindje. Në jug kufizohet me Zallin e Bulqizës i cili e ndan atë nga fshatrat Valikardhë e Zerqan, kurse në perëndim e veri perëndim kufiri i këtij fshati ndjek kurrizin e malit të Temlës, që e ndan nga fshatrat Fushë-Bulqizë dhe Dushaj. Brenda këtyre kufinjve, Peladhia ka një spërfaqe 9.5 km katrore.


Fshati Peladhi shtrihet nga kuota më e ulët 545 m në zalli i Bulqizës në kufirin me Godvinë në lindje, e deri në 1702 m që është maja e malit të Temlës në perëndim. Territori i fshatit ka shtrirje gjatësore 3 km e gjerësi maksimale 4 km që nis nga zalli në fjalë e deri në qafën e Shesheve në kufirin ndarës (lugu i Peladhisë) mes malit të Temlës e Homeshit (të dy pjesë e njësisë së Arithit).

Administrativisht kufizohet në perëndim me Fushë-Bulqizën, në jug-perëndim me Valikardhën, në jug me Zerqanin, në lindje me Godvinë dhe në veriun ekstrem me fshatin Bllacë.

Territori i katundit përfshin një gjeologji të pasur, sidomos sa i takon tektonikës, ndërsa litologjia përfaqësohet me shkëmbinj granitikë pranë gurrave të Peladhisë, karbonatikët e Triasit të sipërm e Jurës së poshtme që ndërtojnë malin e Temlës, pjesërisht terrigenë neogenikë si dhe depozitimeve kuaternare.



Vetë Fshati Peladhi shtrihet në dy lagje, Peladhi e Sipërme dhe Peladhi e Poshtme (regjistrimi austriak i vitit 1916, botuar me 1918, i jep mehalla e eperme dhe mehalla e poshtme, te dyja me 57 shtëpi dhe 373 banore). Katundi i sipërm ka tipologjinë e një vendbanimi të grupuar dobët, me shtëpi të shpërndara, kurse Peladhia e Poshtme është një katund linear me shtrirje perëndim-lindje, gati 1.5 km



përgjatë rrugës nacionale Bulqizë-Peshkopi e paralel me zallin e Bulqizës në jug të tij. Dy shekuj më parë më e zhvilluar ka qenë Peladhia e Sipërme, por pas vitit 1800 përqendrimi më i madh i popullsisë është në lagjen e poshtme, ku ndodhet edhe fondi kryesor i tokës bujqësore.

Emri i katundit lidhet me një ngjarje që ka rrjedhur ndër shekuj në gojëdhënë popullore. Gjatë epokës së artë skënderbeje, ushtarët skënderbegas hodhën në rrëkenë juglindore të Temlës, poshtë kalasë së Skënderbeut, tek Shkëmbi i Kullës, një pelë të dendur me grurë. Turqit që u afruan pranë vendit të ngjarjes panë një kafshë të plasur nga ushqimi i tepërt dhe pyetën "pelë apo dhi". Truku skënderbegas ishte i tillë që krijonte tek armiqtë bindjen se kalaja edhe po të rrethohet nuk merret sepse ka ushqim të mjaftueshëm, aq sa plasin nga tepria edhe kafshët. Prej mesit të shekullit XV e deri më sot, gati 560 vjet, ky fshat ka të njëjtin emër.

Në lindje të fshatit ndodhen rrënojat e një vendbanimi, gjë që e jep edhe harta topografike, por ende nuk kemi të dhëna mbi moshën, përmasat dhe stadin e zhvillimit të tij.

Peladhia është fshat ku vetëm 1/3 e sipërfaqes është luginore, pjesa tjetër është malore e shprehur. Sektori luginor ku ndodhet Peladhia përbën zgjerimin e parë të madh në pjesën lindore të luginës së Bulqizës. E veçanta e luginës në Peladhi është asimetria strukturore e saj. Ku krahu verior në të majtë të zallit është disi i sheshtë dhe i kultivuar, por skaji tjetër i luginës ku kalon zalli lartësohet përnjëherë me shkallën strukturore Zerqan-Valikardhë, me diferencë 200-250 m më në lartësi. Pozita e Peladhisë është mjaft e favorshme, qoftë si vendbanim, por edhe për kushtet bujqësore që ofrohen. Bimësia natyrore është relativisht e pasur, ku vërehet një katëzim perfekt i saj. Rrjeti hidrografik përfaqësohet nga Zalli i Bulqizës që në këtë sektor ka meandrim të shumta, si dhe burimet karstike ku shquhen gurrat e Peladhisë në perëndim të katundit. Tokat janë kryesisht të

kafenjta te tipit te kuqerremte, e pjesërisht aluvionale pranë zallit të Bulqizës.



Peladhia është një fshat mesatar në kuadër të njësisë administrative Zerqan. Për nga numri i popullsisë renditet pas Sopotit, Valikardhës, Strikçanit e Zerqanit. Numri i popullsisë së Peladhisë ka pësuar rënie të ndjeshme gjatë viteve të fundit, si pasojë e emigrimit masiv të rinisë. Në vitin 1997 ky fshat kishte 509 banorë. Në vitin 2001 ra në 446 banorë, në vitin 2007 ra në 388 banorë. U stabilizua në vitin 2011 me 426 banorë, por pas këtij viti ka rënë në më pak se 350 banorë.

Peladhia është fshat historik, me emër të madh në Dibër e më gjerë për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë epokës skënderbeje. Ky katund, u vu në ndihmë dhe dha kontribut të rëndësishëm krah Sheh Zerqanit në luftën e Drinit kundër Hajredin Pashës në vitin 1844. Peladhia do të goditej ashpër nga agresioni serb i vitit 1913 dhe shumë shtëpi të këtij fshati u dogjën. Masakra të rënda përjetoi ky katund gjatë viteve 1913-1921, por që i përballoi me shumë sakrificë. Kontribut të rëndësishëm Peladhia dha gjatë LANC-it, e radhitur me dinjitet në etë Partizane të Grykës së Madhe. Të shumtë janë dëshmorët nga ky fshat që kanë dhënë jetën në luftëra të ndryshme për liri, pavarësi e dinjitet kombëtar.

Fiset kryesore që përbëjnë këtë katund janë Hysa, Kamberi, Plaku, Pata, Kala, Gjura, Rama, Alla, Deda, Dufi, Gjoka, Meta etj.

Peladhia ka një popullsi aktive me punëtorë të zellshëm por edhe një popullsi të arsimuar, e shquar në të gjithë Dibrën. Personalitetet e dala nga ky katund janë të shumtë, por këtu po përmendim disa prej tyre, si Ahmet Kamberin, ministër i shëndetësisë në vitet e fundit të diktaturës, gjuhëtarin e madh, profesorin Enver Hysa, si dhe i ndjeri Bujar Pata, ish-drejtuës i minierës së Bulqizës.

Peladhia është fshat i arsimtarëve të shumtë, me kontribut të rëndësishëm në të gjithë Dibrën për përcjelljen e dijeve, përfshi këtu mësuesin tim të gjeografisë Hasan Gjura.

Ekonomia e katundit është e orientuar nga bujqësia e më pak blegtoaria, e shumë më pak nga artizanati. Edhe pse në një luginë të ngushtë, Peladhia ka një fond të konsiderueshëm toke bujqësore që shkon mbi 100 hektarë, nga të cilat 70 hektarë mjaft prodhuese. Mes për mes fshatit kalon një kanal ujitës i ndërtuar mbi gjysmëshekulli më parë, e që vë në ujë mbi 200 hektarë tokë, gjë që ka sjellë një rritje të ndjeshme të prodhimeve të misrit, foragjereve dhe perimeve në këtë pjesë të luginës së zallit të Bulqizës. Nje pjese e rëndësishme e krahit te punes ka punuar e punon ne minieren e kromit Bulqize.

Peladhia ka disa monumente natyrore e kulturore, shumicën e të cilëve i ndan me fshatrat e tjerë. Një i tillë është Shkëmbi i Kullës, pranë Urës së Qytetit, shpella pranë urës, shpella e zezë, kalaja e Skënderbeut në Shkëmbi i Qytetit, qarri i Peladhisë (në këtë foto të bërë nga unë më 31 maj 2005 me porosi të profesor Qiriazit), ura e vjetër e qytetit etj. Më herët ky fshat ka pasur një mulli uji. Ka një shkollë fillore dhe një rrjet rrugor relativisht të mirë.



Avantazhet e zhvillimit në perspektivë të Peladhisë lidhen me fondin e konsiderueshëm të tokës arë, mundësitë për të shtuar pemëtoret, për të rritur turizmin dhe aktivitetet e biznesit, pasi nëpër fshat kalon rruga e Arbrit, kjo arterie e rëndësishme rrugore që përkrahon qarkun e Dibrës.

Nisur nga pozita gjeografike, e ardhmja e Peladhisë duket e begatë dhe e sigurt, madje shumë më e mirë sesa e Zerqanit që është qendër administrative.

-Një shkrim i shkurtër si (ri)kujtesë  
për publicistin dhe kritikun Halil  
Rama-

suplementi letrat

# Rrëfime rreth kritikës përmes, reportazhit letrar



NGA EMI KROSI

Një emër shumë i njohur është edhe Halil Rama. Një poet, prozator, por më shumë shquhet si një gazetar reportazhesh kulturore. Në shkrimet e tij, përmes vështrimeve vertikale (sepse vetëm reportazhi nuk është një vështrim në thellësi ose horizontal), se modeli shkrimor publicistik- letrar i reportazhit kërkon një specifikë tjetër të të shkruarit.

Libri i tij "Ekzaminimi i diktaturës në veprën letrare" është ndarë në katër kapituj:

1. Nga letërsia artistike; (kryesisht ese dhe kritika për disa emra dhe vepra sa të njohura dhe të panjohura si: Zija Çela, Preç Zogaj, Naim Berisha, Astrit Gjunksi, Setki, Q. Jashari etj.), duke transmetuar vlera tek lexuesi, përmes vështrimeve të thukta por edhe një qasje tjetër, që kritika e njeh: si vështrim sipëfaqësor në formë reportazhi. Ai i shmanget "kurthit biografik", por rrok ato tematika që i duken se ka nevojë lexuesi. Por, studiuesi dhe kritiku Fatmir Terziu, e cilëson "si pozitive penën e tij". Kjo dallohet edhe nga lirshmëria por edhe qasja poetike e shumë librave të botuara. Në këtë qasje, ka më shumë "dinamikë", "kritikë", më pak "eufori" dhe më shumë "gjendje dhe lëng letrar", nga lënda dhe fabulat që sjellin autorët. Ajo, që mori dhe titullin libri, ishte eseja me titull: "Ekzaminimi i diktaturës në romanin "Doktoresha" të Flamur Buçpapajt". Autori rreket të zbërthejë kodet/nënkodet/subkodet e romanit, përmes personazhit të doktoreshë Zanës, ku intrigat e regjimit, apo edhe "gostia e kokëngrënies" është edhe thelbi i ngjizjes së tharmit romanor. Diktaturat rrëzohen, por gjurmët e plagëve lënë aty, gjurmët e "dhimbjeve" të vjetra.

2. Nga letërsia dokumentare: Në këtë pjesë përfshihet letërsia dokumentare e shkruar shumë në të gjitha hapsirat shqiptare, por pak të trajtuara nën syrin e kritikës apo edhe si ese për qëllime letrare me kumte stilistiko-gjuhësore, pasi këto lloje shkrimesh letrare, kanë brenda edhe dokumente historike/biografike/kineamatografike, që enden në shumë kohë. Përmasa e emrave si: Shaban Murati, Mimoza Dajçi, Beqir Sina, Irfan Dashi, Shpëtim Cani etj., ka trajtesa shumë interesante. Libri "Burgjet shqiptare në monarki, gjatë Luftës II Botërore dhe në diktaturë" të Femi Sufaj-t, tregojnë kushtet dhe kohën e ndërtimit të burgjeve në Shqipëri dhe historikun e tyre në kohë. Por, përmes detajeve më të imta, autori hedh dritë më përtej shkrimit autorial të (Femi Sufaj), përkundër kushteve antinjerëzore nëpër burgjet shqiptare. Deri edhe tek marrëzja komuniste me kamp-burgjet, apo edhe burgjet ku diktatura "nënshtronte" elitën e opozitës së saj përmes vrasjeve dhe burgosjes. Libri: "Kam punaur me Edi Ramën" të Irfan Dashit, duket si një qasje "alla Rama" për Ramën. Rrëfimi për kryeministrin e sotëm, përmes shkrimit si dokumentar as nuk ia shton dhe as nuk ia mohan vlerat (sidomos për kundërshtarët politik) apo edhe situatat në familje, nuk ia ulin vlerën tekstit parësor por as guximit të trajtesës së kritikës së Ramës.

3. Reportazhe: (reportazhet për tematika të ndryshme kulturore, letrare, poetike). Përmes temave

si: "fisnikëria tiranase" apo "dita e Maqellarës", "mirënjohja e Elbasanit", ikona e kinematografisë Margarita Xhepa në Bulqizë, etj. Nuk mungojnë edhe reportazhet poetike si:

a) mbi poezinë e Avni Ndreut,  
b) të Barie Çupit,  
c) dhe Setki Q. Jashari, duke iu qasur poezisë së sotme moderne, duke dekoduar kodet poetike të poetëve të lartpërmendur.

4. Tregime: (modele të rrëfimit në prozë në udhën e rrëfimit post/modern).

Sëfundmi: vlera e shkrimeve të Halil Ramës, tejkalon çdo çmim, çdo titull, çdo vlerë honorike, sepse mbizotëron modeli i të qenit "me këmbë në tokë", çdo gjë për librin, gjuhën dhe kulturën shqipe, ka shpallur dimensionin e tij kulturor në disa zhanre, duke na shpërfaqur ato "vlera të harruara" por që qëllimisht nuk vërehen ose përjashtohen. Por syri dhe pena e tij i ka stolitur, për të qenë aty, si dokumente letrare të shkruara, ku çdo libër ka këndin e tij të hapur përgjithmonë për lexuesit e ardhshëm.

\*\*\*

Edhe në librin tjetër "Rilindja e emrave" Halil Rama, përçon elementet poetiko-letrare të qëmtuar deri në imtësi.

Vonë e kam njohur autorin, por shkrimet e tij i kam lexuar. Ndonëse e njoh shumë më herët si gazetar të

kut), që cilësohet si vazhdimësi e emrave.

"Emrat dhe gjuha, janë binomi esencial i identifikimit kombëtar, një pasuri kombëtare që duhet ruajtur e trasmentuar brez pas brezi", ku autori na fton të ruajmë emrat tanë shqiptar, duke eliminuar sa më shumë emrat e huaj (një fenomen modern i prindërve të sotëm).

Prindërit e rinj shqiptar, mendojnë se duke emëruar fëmijën e tij me emër të huaj, quhet modern, por kjo është e gabuar. Trashëgimia e emrave, që në shumë vende të botës, duke filluar që nga fqinjini ynë Greçia, është traditë dhe si vazhdimësi e pemës gjeonologjike e familjes. Andaj, "shuarja" apo "harrësia e qëllimshme" si të vjetra, të emrave të paraardhësve tek pasardhësit, nuk na bën as modern dhe as shpellar, por thjesht një shtyllë e identitetit, që na përfaqëson jo vetëm me gjuhën, por edhe me kulturën tonë kombëtare. Nuk është vetëm shqetësimi i autorit por edhe mbarëshoqëror, se nuk është një metaforizim thjesht poetik, por një shqetësim, sepse nuk na pengon në integrimin, as të shqiptarëve të rinj, as të vjetër në Europë, por ruajta e tyre shihet, si kult i vlerave të harruara, kulturore të shqiptarëve, si një trashëgimi shekullore e unitetit tonë shqiptar.

Duke udhëtuar nëpër shkrimet poetiko-(ese)stike dhe reportazhet, sado që fjalë me plot dashuri dhe përkushtim ndaj njerëzores dhe shpirtërores, nuk ia pakëson meritën për punën shkrimore dhe arkivore Halil Ramë-s, dua të ndaloj tek kreu II, (profile). Mirësia, ngrohtësia si dhe përshkrimet e figurave si: Haziz



reportazheve letrare,

Halili nuk ka reshtur të qëmtojë dhe në gini të tjera, si poezia, proza, monografia, reportazhet historike, Wshhtë bukur por shumë vështirë të shkruash (me stil gazetar për elementet letrare), sidomos në disa refleksione, në skica dhe portrete të njerëzve të fushave të ndryshme.

Por, libri vetë është strukturur në disa krerë:

- kreu I: (esse dhe refleksione),
- kreu II: (profile),
- kreu III: (kritikë letrare),
- kreu IV: (reportazhe).

Në këtë kohe të dytë dua të shpaloj një tematikë ose shqetësim që ka marrë edhe titullin kjo vepër, vijimësia e emrave. Tema përrok saora jo vetëm formësimin e tij si personalitet artistik, por troket tek "porta e harruar" e trashëgimisë së trungut atnor. Pema e Jetës = Pema e Tamblit + Pema e Gjakut, (vazhdimësia e linjës amësore përmes tamlit dhe lidhja me linjën atërore përmes gja-

Ndreut, si ikona e qndresës dibrane apo "ezopi i Dibrës", Xhavit Nimani, Qerim Sula, Muharrem Gjoka, rrok tërë arsenalin e emrave dibranë dhe jo vetëm. Ajo trevë trimash, poetësh, këngëtarësh, folkloristësh, gazetarësh dhe intelektualësh në të gjitha fushat, kanë një zë. "Halil Rama, i jep zëshmëri përmes penës së kujtesës të "harruarve" dhe anatemuarve: "duke i vendosur intelektualët që nuk jetojnë dhe ata që jetojnë dhe kontribuojnë ende, secilin në vendin dhe peidestalin e merituar", shkruan në pasthënie Hajri Mandri.

Sëfundmi: duke i lënë lexuesit e rinj, që të njohin nga afër Halilin, të shkruajnë ose të paktën ta lexojnë (se leximi është pakësuar apo harruar fare), do të gjykojnë vetë. Kjo vjen falë edhe leximeve të tij të vëmendshme dhe të sinqerta, sepse sot vështirë të gjykojë apo të vlerësosh me kthjelltësi dhe profesionalizëm si dhe sa duhet, për dikë që përçon vlera nga rimarrja dhe rindërtimi i vlerave mbi/dhe tekste të tjera.

# Ka ca amanete...

## Cikël poetik nga Barie Çupi

### KA CA KUJTIME...

Ka ca kujtime...  
në sofrën e qiellit ku shtrohen mijëra yje,  
më merr atje me vete më tha vendi im,  
në tespih numërom'hallet, lotët bërë nyje,  
stuhitë, plagë e faje, kurrigjë në këmbim.

### KA CA AMANETE...

vizatome mes reve m'u lut'vendlindja ime,  
mos m'i zgjo të vdekurit, gjith'moshë e brishtë,  
barku bosh m'ka mbet, truri gjuhë e mpime,  
dijersë e muskuj shita, dhe këmishën e mishtë.

### KA ENDE FLETË...

këpus hapin duke marrë e dhënë k'to përgjigje,  
shi e breshër prap, brenda meje ëmbëlsohen,  
m'je dhimt'fthohur ernash, qyteti im pa shtigje,  
sa më larg që iki, aq më tepër të afrohem.

### KU NDODHET....?

Restot e natës si boçe errësirash të paçelura,  
ndërsa hëna lëshon thërime dritash të latuara,  
sërish në zgjim meditojmë copëza endrrash të  
pafjetura,  
Ku ndodhet Zoti,  
a egzistojnë të thënat e sajuara?

### MEDITIM

Mëngjesi më brofi, në këmbë i çarmatosur,  
kafaja memece, u shfajësua variacionesh,  
rrugët e lagështa, siç'muzikë e brengosur,  
i dhash'leje vetes, shqita syt'leksionesh.

S'jam un'e para, as vështrim'i fundit,  
që fjetet e bisedës, i lidhi me veten,  
mbulojat e ngjyrosura, koha na i shkundi,  
të djeshmet mbi lëkurë, gërmash na rreken.

Kush e thotë këtë, veçse të gjithë,  
ç'ledhatime pakuptuar, jetës ia mohuam,  
me mirësjellje kujtesa, pret të na i zgjidhë,  
me një kthinë gjurme, derttet nuk mbaruan.

Nën sqetull ç'pikëpyetje, mbajm'pandehur,  
në ç'skaj të trurit, gjith'nervozat e shpejta,  
ç'njerëz kishim dje, sa pak na kan'mbetur,  
stinësh përplasur, zhbirojmë tek e vërteta.

### PËRTEJ REVE

Mes reve të pafsha më thanë,  
pol më pol u hodha, mbusha fletën e bardhë,  
kanosja e frikës s'më trembi asnjëherë,  
një këngë gjinkalle, më tha udha'mbarë.

Kur kafshimi i fjalëve, më shtypte zërin,  
ëndrrat e gjata, mbi buzë u mavijosën,  
barkçjerrë koha, më kallzoi për iluzionet,  
sa një sumbull, gjokset m'u mblodhën.

Kur tjetri të shtyn, përtej reve ka diell,  
më mjafton një rreze, të ngroh'baltën time,  
në strofulla librash, fsheha shi e breshër,  
mes meje e zotave, gërhimat e stuhive.

Kaluan dallëndyshet, hëna dhe gjurmët,  
gulçimet e jetës, si një klithmë e ngjirur,  
monopatësh malore, piva ujin e freskët,  
u shartova degësh, por rrënjësh jam rritur.

### JETË UNIVERSALE

Ditë pas dite,  
qielli blu, deti blu,  
unë kujtime thyej, e ca i ruaj kuturu.

Dielli s'më llastoi, as s'më përkëdheli,  
koha më shtyu, drejt mjegullës gri,  
tokë e lagur shpirti, si pasqyrë mbeti,  
në çdo nyje një hije, si erë a si shi.



mos u hapëro, por qasu prej mëkatit.

Më zbriti universi mua lajmëtare,  
të rebelohem për zemrat, helmuar pabesie,  
të përflakem qiejsh, sa shumë fytyra,  
të shuaj etjen, në gjokse mirësie.

Ndalesa udhëkryqesh, jam'shteguar jetës  
më mjafton, sot lodhem për një kuptim,  
në don të dish, në ç'tempuj pulsoj,  
e quaj ditëlindje, çdo ditë e çdo agim.

### UNË QESH

Unë qesh...  
dhe pse buzëqeshjen ma grisën disa herë,  
dhe pse dhëmbët shpesh kërcasin e buzët më janë  
ngrirë,  
ca shkarpa fjalësh m'i marrin mend'të,  
kur lot dielli e përkëdhelet në të gdhirë.

Unë qesh...  
dhe pse m'i thyen e m'i shqyen të gjitha ëndrrat,  
e me to ndërtoan tërkuza, gardhe, mure,  
të kacavirrem, kam kurajo, ma ka ënda,  
gjemba, ferra, rrëpirash çjerrë lëkure.

Unë qesh...  
dhe kur dita shkon buzë gremine,  
se i dal para, i hap krahët dhe e mbaj,  
m'janë tretur kockat, sa goditje e lëndime,  
arvoj rrugën veç për zemrën që të mos qajë.

Unë qesh...  
edhe kur ora ecën mbrapa,  
e gjithë shpresën ma ndal koha,  
gjej një shteg e ngacmoj hapat,  
ngjis pasqyrat, bërë fare, copa- copa.

Unë qesh...  
dhe kur më thuret lëmsh krejt fryma,  
dhe kundërmon aromë e heshtjes,  
çarë lëvozhge, shpërthej ashpër sikur rryma,  
ulet jeta e nuk vdes në duart e vdekjes.

Unë qesh...  
dhe pse bora ngrin në vargje e rrin patretur,  
e kur rrëzohem mbyllur sysh në udhëkryq,  
e fsheh mallin e përkëdhel avujt e çmendur,  
dhe fytyrës elegancën nuk ia ngrys.

Unë qesh...  
dhe kur krahët ndiej këputur e thyer bërrylash,  
e dikush pamëshirë shkel fort mbi to,  
mbytem, shtypem, prap çdo çasti ia çel sythat,  
rënkoj nën brinjë, e nuk qaj por qesh me lot.

### TRYSNI PËR EKZISTENCË

Kur zgjohen heshtjet,  
i rrok'gjurmët nata,  
murmurit'errësira përgjumur zgjidhesh të pakta,  
hëna bukë e thyer  
përkulet mendjesh, që s'din'të qetësohen,  
përsëritur pik'pyetjesh, përgjigjet si bisha tërbohen.

Kem'rënë në çark ngatërruar kohërash t'mpihta,  
jem'rrit'krejt dukshëm përdorur nga frika,  
trysni për egzistencë,  
por natyra zemërgjërë, në çdo erë na jep shpresë.

Veç kur zgjohet shpirti,  
lot e vërteta e jetës,  
dielli toka, uj'i jepen lindjes e qëndresës,  
ndaloj papritur,  
me syrin zbrazur n'kraharonin e nënës sime,  
ku cek'brinjësh dashurin', n'çdo grimë e thërime.

Tjera fjalë bëhen kurth,  
pakuptuar ngren'kala,  
në mos past'ndaletë, ka derë e hata,  
dhe emrat më t'pavdekshëm, prap një ditë do  
jen'varre,  
përtej dalë kafazit, të mbyllim luftën e madhe

Natë pas nate,  
heshtja më çoi tutje,  
veç zëra më tunden, e më ikin në zhdukje.

Hëna nuk më qeshi, as e imët, as e plotë,  
as humbur, as fituar, zemra m'është kopsitë,  
ca grimca lotësh, rënë ngamos përtokë,  
në çdo shteg një mall, e prek në çdo muzikë.

Bota pafund botë  
e sërish viti, vit  
thonjsh poezia, më ka heq e më ka shkit'

Toka m'i varrosi, gjith'mëritë nën këmbë,  
në paqe përtypem, prej orësh të dal,  
krejt lehtë udhëtoj e nuk ndihem rëndë,  
dëfrejnë pikëpyetjet, rrugëtim universal.

### PËR NJË KUPTIM...

Kurmi'të tokës shpërthejn'sythe lotësh,  
shuhen e ndizen zjarre hakmarrjesh,  
mrizi i ëndrrave, psherëtin harresash,  
në mendime primitive, koka përplasjesh.


O frymë e gjallë e botës njerëzore,  
oqean shtrat'tharë, i kohës moderne,  
uraganesh shpirtërore, mëshiroju Perëndisë,  
mëngjesesh me diell, zgjohu kujtese.

Rrëmbe një çast e duaje jetën,  
o dorë e djegur, në prushin e të marrit,  
endacak shkretëtirash, në ethe trishtimi,


# fotoreportazh

Fabrika pasurimit Kromit sh.p.k  
Bulqizë

Prodhimi i mineralit dhe koncentratit të kromit ne vite




Numri i punonjese ne objektet minerare dhe perpunuese




Fabrika pasurimit Kromit sh.p.k  
Bulqizë

INVESTIMET DHE TREGUESIT E PRODHIMIT GJATE VITEVE  
Prodhimi i koncentratit të kromit ne vite



Investimet e realizuara ne vite kapin ne total shifren prej 5.2 milion USD  
Ne teknologji 4.0 milion USD  
Ne rehabilitim mjedisor 1.2 milion USD

## FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT BULQIZË ME SIPËRMARRËS BUKUROSH KOÇIN, NDËR MË TË SUKSESSHMET NË RANG VENDI



Frytet e para janë dhënë që me përfundimin në masën 50 % të projektit, nga i cili është arritur të prodhohet 2800 kwh në ditë

### INVESTIMI NË FABRIKË, 840 MIJË EURO PËR PANELET DIELORE

Në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë po ndodh një “revolucion teknologjik”. Pasi ka sjellë dhe implementuar teknologjitë më të përparuara botërore në mjediset e fabrikës, Administratori i saj, Ing. Bukurosh Koçi, po realizon një tjetër investim madhor. Projekti konsiston në instalimin e paneleve diellore, për realizimin e të cilit po investohen 840 mijë euro. Është një investim që do i shërbejë perspektivës, duke ulur në maksimum shpenzimin e energjisë elektrike. Dhe frytet e para janë dhënë që me përfundimin në masën 50 përqind të projektit, nga i cili është arritur të prodhohet 2800 kwh në ditë.

fantazia dhe shpirti krijues i B.Koçit. Një tjetër investim madhor i këtij sipërmarrësi është Fabrika e Pasurimit të Kromit në Kalimash. Është një investim shqiptaro-austriako-suedez. Në fabrikë është instaluar teknologjia më moderne, e cila përdor një metodë nga më të suksesshmet, që ka përparësi mbrojtjen e mjedisit. Investimet e kryera rezultojnë që kapaciteti përpunues i fabrikës është afro 40000 ton në vit mineral i pasuruar dhe koncentrat kromi. Në këtë fabrikë, ku faza e parë e investimit kap vlerën prej 3,5 milionë euro, janë punësuar deri tani mbi 150 punonjës.

Me punën intensive që po kryhet, Ing.Koçi shpreh bindjen se brenda 20-30 ditëve do të vihen në punë të gjitha panelet dhe kjo do të sjellë dyfishimin e kapacitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

Ky projekt po realizohet falë vizionit bashkëkohor, përkushtimit dhe aftësisë të rralla të Bukurosh Koçit, një ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në rang kombëtar.

T’ia nisesh nga e para. Por duhet të dish kur është momenti për t’ia nisur e çka është më me rëndësi të mos ndalesh nga vështirësitë. Ky është stili i punës, i metabolizuar në shpirtin krijues dhe novator të inxhinier Bukurosh Koçit. Në bashkëpunim me një kompani tjetër, fabrikës së pasurimit të kromit në Bulqizë iu bashkëngjiti e privatizuar një ish - fabrikë e vjetër e pasurimit të kromit në Gjakovë, ku edhe këtu spikat

